# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6075
E mërkurë, 29 korrik 2020
çmimi 0.40 €


## Shtatë të vdekur dhe 239 raste të reja me Covid-19

FAQE 8





Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI DHE MINISTRI I SHËNDETËSISË, ARMEND ZEMAJ, KANË VIZITUAR QENDRËN MJEKËSORE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

# SITUATA ME COVID, NË RAST NEVOJE DO TË PËRDORET EDHE SPITALI USHTARAK I FSK-së



Kryeministri Avdullah Hoti ka inspektuar të martën Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai ka thënë se po punohet që t'i integrojë kapacitetet shëndetësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për ta përballuar situatën e shkaktuar nga pandemia e koronavirusit. Kryeministri ka deklaruar se situata me pandeminë po përkeqësohet, duke shtuar se të gjitha institucionet e Kosovës duhet të përgatiten për t'u përballur me këtë sfidë. Sipas Hotit, qeveria do t'i qëndrojë afër Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së për t'i ngritur më tutje kapacitetet e kësaj force në këtë drejtim

## SHQIPTARËT NË MAL TË ZI GAROJNË ME NJË LISTË TË PËRBASHKËT NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE



Partitë shqiptare në Mal të Zi kanë nënshkruar të martën marrëveshjen e koalicionit gjithëpërfshirës për zgjedhjet parlamentare të 30 gushtit. Kjo marrëveshje është nënshkruar në mes të Forcës së Re Demokratike, Alternativës Shqiptare, Lidhjes Demokratike Shqiptare, Unionit të Tuzit si dhe Lëvizjes Qytetare Perspektiva

## ZHBLLOKOHET XHIROLLOGARIA E TELEKOMIT

FAQE 6

### OPINION

**LEKSIONET E VUÇIQËVE, DAÇIQËVE E TË GJURIQËVE PËR SHQIPTARËT** F. 11



Nga Jakup KRASNIQI

### AKTUALE

**SHQIPËRI, INFEKTOHEN ME COVID-19 TRE DEPUTETË DHE KRYEBASHKIAKU I TIRANËS** F. 2

**LUFTA KUNDËR PANDEMISË, THAÇI PREMTON PËRKRAHJE PËR PERSONELIN SHËNDETËSOR** F. 3

**TË ENJTEN PRITET TAKIMI I RADHËS HYSENI - GJURIQ** F. 5

### EKONOMI

**PËRFITIMET DHE DËMET NGA TËRHEQJA E PARAKOHSHME E KURSIMEVE PENSIONALE** F. 7

**NJOHËSIT E EKONOMISË VENDORE, OPTIMISTË PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE TË KOSOVËS** F. 9

### KULTURË

**BOTOHET LIBRI "IMIGRIMI NGA BALLKANI PERËNDIMOR" I BASHKAUTORES VJOLLCA HAJDARI** F. 12




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net I www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Shqiptarët në Mal të Zi garojnë me një listë të përbashkët në zgjedhjet parlamentare

Partitë shqiptare në Mal të Zi kanë nënshkruar të martën marrëveshjen e koalicionit gjithëpërfshirës për zgjedhjet parlamentare të 30 gushtit. Kjo marrëveshje është nënshkruar në mes të Forcës së Re Demokratike, Alternativës Shqiptare, Lidhjes Demokratike Shqiptare, Unionit të Tuzit si dhe Lëvizjes Qytetare Perspektiva




EPOKA E RE Qendresa RAMA

PODGORICË, 28 KORRIK - Partitë shqiptare në Mal të Zi kanë nënshkruar të martën marrëveshjen e koalicionit gjithëpërfshirës për zgjedhjet parlamentare të 30 gushtit. Kjo marrëveshje është nënshkruar në mes të Forcës së Re Demokratike, Alternativës Shqiptare, Lidhjes Demokratike Shqiptare, Unionit të Tuzit si dhe Lëvizjes Qytetare Perspektiva. "Ky bashkim i partive kryesore shqiptare të Malit të Zi bëhet në interes të popullit tonë duke synuar maksimalizimin e votës shqiptare. Shpreh mirënjohjen ndaj diasporës dhe aktorëve të tjerë politikë, që kanë këmbëngulur për të krijuar një listë të përbashkët elektorale që do të mundësojë një përfaqësim më të denjë e të plotë të popullit shqiptar në Parlamentin e Malit të Zi", ka thënë, pas nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari i Forcës së Re Demokratike, Nazif Cungu.

Nik Gjeloshaj, kryetar i partisë Alternativa Shqiptare, ka thënë se ky bashkim përfaqëson shqiptarët pa dallime, nga bregu i Buenës e deri në Dacaj të Rozhajës. "Ky bashkim përfaqësohet me 15 këshilltarë në Kuvendin e Tuzit, 9 në Kuvendin e Ulqinit, 5 në Kuvendin e Gucisë, me nga një këshilltar në Kuvendin e Plavës dhe Podgoricës. Në total, 31 nga 41 këshilltarët e subjekteve nacionale ose 71 për qind të përfaqësimit politik nacional. Po ashtu, pjesë e këtij koalicioni janë: nënkryetari i Parlamentit të Malit të Zi, kryetari i Komunës së Tuzit, kryetarët e kuvendeve të Komunës së Ulqinit dhe Tuzit, nënkryetarët e Komunës së Tuzit dhe Gucisë...", ka thënë Gjeloshaj.

Ai ka thënë se ka ardhur koha që elektorati shqiptar ta diferencojë politikën shqiptare, duke theksuar se ky koalicion është alternativa më e mirë, unike dhe më gjithëpërfshirëse. "Ky koalicion na jep shpresë dhe optimizëm që së bashku me diasporën dhe të gjithë shqiptarinë do të dalim fitues absolutë më 30 gusht. Apeli ynë kombëtar: asnjë votë për subjektet e ashtuquajtura qytetare. Vota shqiptare vetëm për shqiptarë, për listën më të mirë, për koalicionin tonë!", është shprehur ai, duke shtuar se shqiptarët gjithmonë kur u bashkuan, ia dolën.

# Shqipëri, infektohen me Covid-19 tre deputetë dhe kryebashkiaku i Tiranës

TIRANË, 28 KORRIK - Në Shqipëri tre deputetë të Kuvendit kanë rezultuar pozitivë në rezultatin për Covid-19 e, po ashtu, i infektuar ka dalë edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. I pari që njoftoi se kishte dalë pozitiv ishte deputeti Ralf Gjoni. Ai njoftoi në "Facebook" dhe bëri me dije se gjendja e tij shëndetësore ishte e mirë dhe se po qëndronte i izoluar. Më pas u mësua se të prekur ishin edhe dy deputetë të tjerë, Enver Rroshi dhe Elio Hysko. Ky i fundit ka bërë me dije se e ka kaluar fazën e izolimit.

Është urdhëruar dezinfektimi i sallës së Kuvendit dhe mjediseve administrative, ndërsa dy seancat e ditës së nesërme dhe pasnesërme do të zhvillohen të reduktuara dhe koha e fjalimeve të deputetëve do të shkurtohet.

Po gjatë ditës së sotme edhe kryebashkiaku Veliaj njoftoi se ishte prekur nga koronavirusi dhe se për këtë arsye ishte izoluar në banesë dhe do ta vijonte punën në distancë. Si kryebashkiaku Veliaj ashtu edhe deputetët e infektuar u bënë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë masat e sigurisë dhe të mbajnë maska për ta kufizuar përhapjen e virusit.

Në Shqipëri gjendja po njeh vetëm përkeqësim, me një numër të shtuar të rasteve të reja, por edhe të viktimave dhe atyre që shfaqin shenja të rënda klinike.

## Katër viktima e 117 raste të reja në 24 orët e fundit

Edhe të dhënat e ditës së sotme konfirmojnë të njëjtën tendencë në rritje të vënë re që prej mesit të muajit qershor, kur autoritetet lehtësuan masat shtrënguese. Në spitalin "Shefqet Ndroqi" humbën jetën katër persona të tjerë, "një 84-vjeçare nga Shkodra, një 75-vjeçar nga Tirana pa sëmundje të tjera, si dhe dy qytetarë nga Tirana: një 78-vjeçar dhe një 82-vjeçar, me sëmundje bashkëshoqëruese", bëri të ditur Ministria e Shëndetësisë. Në total, numri i viktimave ka arritur në 148 persona.



Rastet e reja, gjithashtu, mbeten në nivele të larta. "Në 24 orët e fundit janë kryer 507 testime për të dyshuar të prekur me Covid-19, nga të cilat janë konfirmuar 117 raste pozitive", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë. Sërish gjysma e tyre janë zbuluar në Tiranë, ndërsa të tjerët në 18 qytete të ndryshme të vendit. Me të prekurit e konfirmuar së fundi, numri i të infektuarve arriti në 4 997 raste. Krahasuar me tre muajt e parë, që nga fillimi i pandemisë, ka thuajse një katërfishim të personave që rezultojnë pozitivë ndaj Covid-19.

Në të dy spitalet e kryeqytetit ku po trajtohen të sëmurët, numri i të shtruarve mbetet problematik. "Aktualisht në spitalin Infektiv dhe spitalin 'Shefqet Ndroqi' po trajtohen 123 pacientë, nga të cilët 22 janë në terapi intensive dhe 7 pacientë janë të intubuar", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë gjatë përditësimit të të dhënave pasditen e së martës.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Lufta kundër pandemisë, Thaçi premton përkrahje për personelin shëndetësor



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë një bashkëbisedimi me drejtuesit e institucioneve shëndetësore në hapësirat e QKUK-së, ka thënë se personeli shëndetësor e ka përkrahjen e të gjitha institucioneve shtetërore sa i takon luftimit të pandemisë Covid-19. Duke vlerësuar lart punën e personelit shëndetësor, Thaçi ka thënë se ata janë heronjtë e ditëve të sotme. "Me të vërtetë ka qenë një betejë dhe vazhdon të mbetet betejë e madhe. E jona është që t'ju mbështesim maksimalisht, me të gjithë potencialin shtetëror që e kemi", ka thënë Thaçi

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

**Prishtinë, 28 korrik** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka vizituar të martën Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK), ku ka zhvilluar një bashkëbisedim me stafin mjekësor - mjekët dhe infermierët, të cilët i ka falënderuar për punën dhe përkushtimin e tyre në betejën me pandeminë Covid-19.
Presidenti Thaçi ka thënë se personeli mjekësor e ka përkrahjen e të gjitha institucioneve. "Me të vërtetë ka qenë një betejë dhe vazhdon të mbetet betejë e madhe. E jona është që t'ju mbështesim maksimalisht me të gjithë potencialin shtetëror që e kemi. Unë dëshiroj t'ju shpreh ngushëllimet më të sinqerta për kolegët tuaj dhe natyrisht për çdo qytetar që e ka humbur jetën, por edhe t'u uroj shërim sa më të shpejtë të gjithë të prekurve", ka thënë presidenti Thaçi, duke shtuar se punëtorët shëndetësorë janë heronjtë e ditëve të sotshme. "E di që keni qenë shembull për rajonin dhe më gjerë. Keni marrë veprime shumë të shpejta, të sakta dhe precize. Më vjen mirë që është një mobilizim i të gjithë mjekëve, stafit të mjekësisë këtu dhe, gjithashtu, edhe në nivel lokal. E kemi biseduar edhe me qeverinë, edhe Ministrinë e Shëndetësisë, kryeministrin Hoti dhe gjithë të tjerët, të jeni të sigurt se do ta keni përkrahjen e të gjitha institucioneve në mënyrë që ta tejkaloni sa më lehtë dhe me më pak pasoja", ka thënë ai.
Presidenti Thaçi ka shprehur besim të plotë në forcën, energjinë dhe dijen e mjekëve tanë, por edhe në disiplinën qytetare për ta tejkaluar sa më lehtë pandeminë.
Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit të Shërbimit Spitalor të Kosovës (ShSKUK), Valbon Krasniqi, ka treguar për numrin e personave të cilët janë të shtrirë në QKUK dhe spitale të tjera regjionale, derisa ka theksuar se janë duke bërë riorganizimin sa i përket nevojës për rritjen e kapaciteteve të shtretërve për t'i trajtuar personat e infektuar me Covid-19. Sipas tij, stafi shëndetësor në këtë kohë më së shumti ka nevojë për përkushtim dhe vëmendje të institucioneve. "Kemi arritur që deri tani të bëjmë riorganizimin në kuptim të asaj që kemi vënë 700 deri në 750 shtretër në dispozicion për pacientët me Covid nëpër spitalet rajonale dhe në klinikat e Qendrës Klinike Universitare. Dhe, po ashtu, kemi angazhuar një numër të madh të personelit shëndetësor dhe të profileve të tjera që janë duke trajtuar pacientët. Sot, në këto çaste, kemi rreth 600 pacientë të shtrirë nëpër klinikat e QKUK-së dhe në spitalet rajonale, qoftë të dyshuar ose të konfirmuar me infeksionin Covid. Gjendja shëndetësore e tyre vazhdon të mbetet e rëndë. Kemi mbi 40 pacientë që janë në aparate respiratorë, qoftë të intubuar, qoftë me metoda të tjera, dhe kemi mbi 300 pacientë që po trajtohen me oksigjeno-terapi. Nga ky numër tani kemi 270 pacientë në klinikat e QKUK-së dhe mbi 330 nëpër spitalet rajonale. Pra, kemi ofruar një qasje të regjionalizimit të pacientëve, në mënyrë që pacientët me forma më të lehta të trajtohen në kuadër të spitaleve të tyre rajonale", ka shtuar Krasniqi.
Në anën tjetër, drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKShPK), Naser Ramadani, ka treguar për gjendjen e rënduar ditët e fundit. Ai ka bërë thirrje që të respektohen tri masat vendimtare: distanca fizike, mbajtja e maskës dhe higjiena personale. "Për ne është gjendje alarmante të thuhet se mund ta ulin lakoren epidemiologjike. Këtë lakore epidemiologjike do të mund ta ulim duke pasur parasysh të gjitha planet e gatishmërisë të cilat i kemi bërë deri më tani. Dhe të gjitha vendimet që janë marrë nga rekomandimet e Institutit Kombëtar të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Qeveria e Kosovës. Dhe me këtë, thelbi i këtyre vendimeve konsiston në marrjen e masave nga çdo qytetar i Kosovës: në mbajtjen e distancës, në vënien e maskave dhe në mbajtjen e higjienës personale. Të gjitha këto janë vendime të të gjithë neve, pa marrë parasysh ku gjendemi", ka theksuar Ramadani.
Më tutje, drejtoresha e Klinikës infektive, Lindita Ajazaj-Berisha, ka theksuar se kjo klinikë ka organizuar punën rreth Covid-19 që nga 8 shkurti, kur kishin filluar rastet e para të dyshimta, ndërsa nga 13 marsi janë konfirmuar rastet e para. Kurse infektologu Salih Ahmeti ka thënë se puna me pacientët me Covid është sfiduese për ta pasi, sipas tij, është shtuar numri i nevojave për shërbime.

# Hoti priti në takim ambasadorët e shteteve të Quintit, temë diskutimi dialogu Kosovë - Serbi

**Prishtinë, 28 korrik (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga Koordinatori Shtetëror për Dialogun me Serbinë, Skender Hyseni, ka pritur të martën në takim ambasadorët e shteteve të Quintit.
Sipas njoftimit të qeverisë, në këtë takim është biseduar për zhvillimet aktuale në vend, me theks të veçantë në procesin e dialogut me Serbinë, i cili, siç ritheksoi kryeministri Hoti, duhet të përmbyllet me njohje reciproke dhe normalizim të marrëdhënieve në mes dy vendeve. "Po ashtu, kryeministri Hoti i ka njoftuar ambasadorët e Quintit dhe shefen e Zyrës së Bashkimit Evropian/Përfaqësuese e Posaçme e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, për masat që po ndërmerr Qeveria e Kosovës për parandalimin e pandemisë Covid-19 dhe për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike", është bërë me dije në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.





Kryeministri Avdullah Hoti dhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, kanë vizituar Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës

# Situata me Covid, në rast nevoje do të përdoret edhe spitali ushtarak i FSK-së

Kryeministri Avdullah Hoti ka inspektuar të martën Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ai ka thënë se po punohet që t'i integrojë kapacitetet shëndetësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për ta përballuar situatën e shkaktuar nga pandemia e koronavirusit. Kryeministri ka deklaruar se situata me pandeminë po përkeqësohet, duke shtuar se të gjitha institucionet e Kosovës duhet të përgatiten për t'u përballur me këtë sfidë. Sipas Hotit, qeveria do t'i qëndrojë afër Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së për t'i ngritur më tutje kapacitetet e kësaj force në këtë drejtim

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 KORRIK - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka vizituar të martën Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës për t'u informuar më hollësisht për përgatitjet që po bëhen për ngritjen e kapaciteteve të FSK-së. Pas vizitës në Spitalin Ushtarak të FSK-së, kryeministri Hoti ka deklaruar se po punohet që t'i integrojë kapacitetet shëndetësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës për ta përballuar situatën e shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.

"Bashkë me ministrin e Shëndetësisë inspektuam Spitalin Ushtarak, për t'i parë kapacitetet që FSK-ja do t'i vërë në dispozicion të qendrës spitalore, në rast se do të kemi nevojë që t'i përdorim këto kapacitete. Unë nuk jam shumë njeri ushtarak, por jam i impresionuar kur hyj brenda, por edhe i emocionuar me disiplinën ushtarake dhe përgatitjet e Ministrisë së Mbrojtjes, të FSK-së, një disiplinë që na bën krenarë", ka deklaruar Hoti.

Ai ka theksuar se qeveria do t'i qëndrojë afër Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së për t'i ngritur më tutje kapacitetet e kësaj force në këtë drejtim. "Duhet t'i qëndrojmë afër Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së për t'i ngritur edhe më tutje kapacitetet. Do të punojmë bashkë me stafin shëndetësor të FSK-së që të integrohen me Ministrinë e Shëndetësisë dhe me Shërbimin Spitalor të Kosovës për ta përballuar situatën nëpër të cilën po kalojmë", ka thënë Hoti.

Ai ka deklaruar se situata me pandeminë po përkeqësohet, duke shtuar se të gjitha institucionet e Kosovës duhet të përgatiten për t'u përballur me këtë sfidë. "I falënderova edhe për mbështetjen që ua ka dhënë FSK-ja në tre-katër muajt e fundit institucioneve të tjera për ta menaxhuar situatën, e cila tashmë po duket se po përkeqësohet dhe ne duhet të përgatitemi për të gjitha variantet që mund t'i kemi përpara gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm", ka thënë kryeministri Hoti, duke falënderuar ministrin Quni, gjenerallejtënant Ramën dhe të gjithë pjesëtarët e FSK-së për këto përgatitje.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, e ka njoftuar kryeministrin Hoti me gjendjen si e ka gjetur ministrinë dhe FSK-në, me punën që është bërë edhe nga ministrat paraprakë dhe me angazhimet aktuale për tranzicionin e FSK-së, bazuar në ligjet e reja dhe me mision të ri, që ka Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja.

Ai, gjithashtu, e ka njoftuar kreun e qeverisë për angazhimin e FSK-së në kuadër të gjendjes së pandemisë Covid-19, ku FSK-ja ka dhënë kontribut në mbështetje të autoriteteve civile, me logjistikë, transport dhe gatishmërinë që ka për të dhënë mbështetje me kapacitete shtesë në rast të përkeqësimit të gjendjes, duke vënë në dispozicion edhe kapacitetet për akomodim dhe për trajtim.

### Kryeministri inspekton edhe "Hammëv"-t amerikanë të FSK-së

Më pas kryeministri Avdullah Hoti ka parë nga afër edhe pajisjet e fundit ushtarake të FSK-së të blera me buxhetin e Kosovës. Me këtë rast, komandanti i FSK-së,



gjenerallejtënant Rrahman Rama, e ka njoftuar kreun e qeverisë për procedurat e pranimit teknik të këtyre pajisjeve dhe për shpërndarjen e tyre varësisht nga nevojat, duke thënë se kjo është në vazhdimësi të procesit të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së bazuar në mandat dhe mision të ri. "Kjo është një vazhdimësi e procesit të ngritjes së kapaciteteve bazuar në mandat të ri. Këtu janë disa, kemi edhe disa të tjera që janë dhuruar vitin e kaluar nga ShBA-ja, 27 'Hammëv', 24 i kemi blerë me buxhet të Kosovës dhe jemi në vazhdimësi të ngritjes së kapaciteteve", ka thënë Rama.

Gjithashtu, gjenerallejtënant Rrahman Rama e ka njoftuar kryeministrin Hoti me angazhimet konkrete të FSK-së, me planin e zhvillimit dhe transformimit, me trajnimet dhe shkollimet që po bëjnë ushtarët dhe oficerët e FSK-së në akademitë ushtarake të vendeve mike dhe partnere. Ai e ka njoftuar kreun e qeverisë edhe për menaxhimin e financave të FSK-së, buxhetin aktual dhe pajisjen me teknikë të nevojshme për ta rritur operacionalitetin e FSK-së sipas planit të zhvillimit dhe ngritjes së FSK-së.

Kurse Hoti e ka përgëzuar gjenerallejtënant Ramën për punën që po bëjnë, duke theksuar se është mirë që kjo punë po bëhet bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë, por normalisht me buxhet të Republikës së Kosovës.

"Ne do t'ju qëndrojmë afër edhe në vitet e ardhshme, për t'i plotësuar nevojat e FSK-së dhe për ta zbatuar plotësisht planin afatgjatë të ngritjes së kapaciteteve të FSK-së. Unë jam sot këtu edhe për të demantuar çfarëdo informate që del në mediat ndërkombëtare lidhur me këtë furnizim që ka pasur FSK-ja. Kjo është plotësisht në përputhje dhe në marrëveshje me parterët tanë ndërkombëtarë", ka deklaruar Hoti.

# Të enjten pritet takimi i radhës Hyseni - Gjuriq

Prishtinë, 28 korrik - Ekipet e ekspertëve, në kuadër të dialogut midis Kosovës dhe Serbisë, do të takohen gjatë kësaj jave. Sipas burimeve brenda Bashkimit Evropian, takimi pritet të zhvillohet të enjten dhe aty do të bisedohet për temat që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ekonomik, raporton "Rel".

Ky do të jetë takimi i dytë në nivel ekspertësh, pasi më 23 korrik përfaqësuesit e Kosovës dhe Serbisë u takuan në Bruksel dhe biseduan për çështjen e të pagjeturve dhe të zhvendosurve.

Kosova në dialogun në nivelin e ekspertëve përfaqësohet nga koordinatori shtetëror për dialog, Skender Hyseni, ndërkaq Serbinë e përfaqëson drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq.

Koordinatori shtetëror për dialog, Skender Hyseni, pas takimit me palën serbe më 23 korrik, deklaroi se nuk do të ketë marrëveshje për kapituj të veçantë përderisa nuk arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse.





Në Kosovë, kryeministri Avdullah Hoti, por edhe koordinatori Skender Hyseni, insistojnë se dialogu me Serbinë është vetëm në nivelin politik dhe nuk do të ketë diskutime teknike. Të gjitha takimet, siç ka deklaruar koordinatori Hyseni pas takimit të 23 korrikut, do të kenë për qëllim përgatitjet rreth draftimit të një marrëveshjeje finale, gjithëpërfshirëse.

Burimet në BE pohojnë se varësisht nga rrethanat, gjatë vjeshtës presin rritje të dinamikës së takimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në mënyrë që të përshpejtohet arritja e një marrëveshjeje. Synohet që takimet në nivel ekspertësh të mbahen çdo javë dhe dy herë në muaj të ketë takime në nivel të lartë politik ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq.

# Quni e njofton Hotin për luftën speciale të mediave ruse për FSK-në

Gjatë vizitës në Qendrën Mjekësore të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), në kazermën "Adem Jashari", ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, e ka njoftuar kryeministrin me luftën speciale që po bëhet në mediat ruse se, kinse, FSK-ja ka blerë armatim fshehurazi nga Gjermania në vlerë deri në 170 milionë euro. Quni ka thënë se të gjitha këto bëhen për ta destabilizuar paqen në Ballkan dhe për të krijuar pretekst për armatosjen e mëtejme të Serbisë si dhe duke tentuar ta komprometojë bashkëpunimin tonë të mirë dhe transparent me shtetin e Gjermanisë. Sipas Qunit, Kosova është e orientuar në kapacitetet mbrojtëse, e ka buxhetin transparent dhe ngritja e FSK-së është duke u bërë në koordinim me partnerin strategjik - ShBA-në dhe në transparencë me NATO-n. Ai ka thënë se Kosova nuk ka shprehur asnjëherë ambicie territoriale ndaj fqinjëve, ashtu si Serbia që e ka Kosovën ende në preambulën e Kushtetutës.

# ShSKUK-ja dhe Spitali i FSK-së rrisin bashkëpunimin

Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka vizituar Spitalin Ushtarak të FSK-së, ku me drejtorin e këtij spitali, dr. Shkëlzen Syla, kanë diskutuar në lidhje me hapësirat dhe kapacitetet që ka QMFSK-ja dhe për mundësinë e mbështetjes me staf mjekësor nga ana e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës.

Drejtori i Qendrës Mjekësore të FSK-së, dr. Shkëlzen Syla, ka treguar se kanë kapacitet prej 60 shtretërish me të gjitha pajisjet e nevojshme, përfshirë edhe laboratorin dhe pjesën diagnostiko-radiologjike. Gjatë vizitës në kabinete të ndryshme të Qendrës Mjekësore të FSK-së, dr. Syla e ka njoftuar drejtorin e ShSKUK-së lidhur me kapacitetet në personel dhe pajisjet mjekësore që ka në dispozicion drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së. Ai ka ofruar mbështetjen e tij për FSK-në bazuar në nevojat që ka kjo qendër mjekësore dhe në memorandumin e nënshkruar më herët ndërmjet dy institucioneve.

# Reçica viziton OVLUÇK-në, diskutojnë për gjendjen e veteranëve

Prishtinë, 28 korrik (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka vizituar të martën Organizatën e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK). Bashkë me kryetarin e kësaj organizate, Hysni Gucati, kanë diskutuar për gjendjen e veteranëve në këtë situatë të vështirë pandemike dhe për tema të tjera me interes të përbashkët. "Kryetarin Gucati e njoftova dhe mora mbështetjen e plotë të tij për nismat tona lidhur me ndryshimet e nevojshme ligjore që ua mundëson të gjithë veteranëve të luftës së UÇK-së të drejtën për të punuar në sektorin privat, si dhe për lejimin e përfitimit edhe të pensioneve meritore për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Me kryetarin Gucati u pajtuam dhe dhashë mbështetje që të gjitha hallet dhe kërkesat e tyre do të realizohen në përputhje të mundësive tona buxhetore dhe legjislacionit në fuqi", ka thënë Reçica pas takimit.



# LEKSIONET E VUÇIQËVE, DAÇIQËVE E TË GJURIQËVE PËR SHQIPTARËT



Nga Jakup KRASNIQI

Eh, kush qenkan përpjekur të japin leksione për librat, për kartën e OKB-së, për Rezolutën 1244, për të Drejtën Ndërkombëtare! Duke harruar ta përmendin edhe Vendimin e GjND-së të 22 korrikut 2010, i cili i tregoi Serbisë se pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me Ligjin Ndërkombëtar. Dhe liderët e "rinj" serbë në Beograd këtë dokumentin e fundit duhet që ta mbajnë vath në vesh. Ai u tregon se duhet ta nxjerrin mësimin e duhur nga veprat e kryera të krimit e të gjenocidit në ish-shtëpinë e tyre, ish-Federatën Jugosllave, të cilën e shkatërruan me tanke e autoblinda, me avionë e helikopterë, me mina e mortaja, me topa e mitraloza dhe kudo mbollën vdekjen deri dhe në Batajnicë, me eskadrilat e tyre të vdekjes. Tani vuçiqëve, daçiqëve e gjuriqëve nuk u ka mbetur gjë tjetër veçse t'ia vënë minat edhe Serbisë e Beogradit! Vetëm edhe kjo mundësi u ka mbetur!

Shpejt, tepër shpejt, nxënësit kujtesështkurtër të kriminelit Milloshevliq paskan harruar se OKB-ja ia dha lejen NATO-s për të bombarduar për 78 ditë Serbinë. Gjithashtu, paskan harruar se Rezoluta 1244 ka prodhuar çlirimin e Kosovës, dëbimin e Serbisë nga Kosova së bashku me UÇK-në (pa UÇK-në asgjë nuk do të lëvizte, duhet thënë kjo pa ekuivok), pastaj solli Administrimin Ndërkombëtar në Kosovë dhe, më pas, Kornizën Kushtetuese të Kosovës pasuar me bisedimet e Vjenës të udhëhequra nga përfaqësuesi i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Mati Ahtisari. Këto bisedime sollën dokumentin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, i cili dokument solli pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008! Ky finalizim është bërë në bashkërendim të plotë me OKB-në dhe Grupin e Kontaktit. Është fakt se këto dokumente duhet t'i njohin mirë shqiptarët, por jo më pak se shqiptarët duhet që t'i njohin edhe serbët mendjeshthurur. Serbët, që duhet të mësojnë nga librat e mirë e jo nga përrallat e mitomanisë gënjeshtare, e cila ka derivuar vetëm mashtrim e armiqësi gjatë historisë.

Ne, që kemi mësuar nga librat e besueshëm, kemi ditur të gjejmë miq të pangarkuar, realë, kemi mësuar se si duhet atdheu dhe çka duhet bërë për ta çliruar dhe këtë e arritëm në qershorin e vitit 1999. Ishin librat jo vetëm të besueshëm, të mirë, të pangarkuar nga lakmitë shekullore, sikundër ishin virtytet e trashëguara nga Skënderbeu që brezat i jetësuan praktikisht duke dëshmuar sesi duhet të luftohet për liri e atdhe. Ishte flijimi i Adem Legjendarit që së fundi këndelli kombin drejt rrugës së çlirimit, lirisë e pavarësisë.

Ne dhe miqtë e besueshëm krijuam një standard të ri edhe për komunitetin pakicë serb në Kosovë sesi duhet të bashkëjetojmë si njerëz. Ne, edhe kur marrim tanke nga miqtë tanë, në asnjë rast nuk mendojmë që t'i përdorim kundër shtëpisë sonë dhe këtë mësim e kemi nxjerrë nga pësimi lakmitar e hegjemonist milloshevigian. Tanket na duhen për ta mbrojtur Kosovën, paqen, lirinë e pavarësinë tonë, jetën e nderin e njeriut tonë, pra edhe të serbëve të Kosovës! Ne nuk mësojmë nga ëndrrat liderucësh postmilloshevigianë të çmendur deri në vetëshkatërrim. Ne udhëhiqemi nga ëndrrat tona liridashëse e atdhedashëse, nga ëndrrat tona për zhvillim e mirëqenie. Ne, gjithashtu, jemi të lumtur që në rrugëtimin tonë drejt lirisë e pavarësisë patëm e kemi shumë miq! Që ishin ngopur e stërngopur me gënjeshtra shekullore mitmëdha serbosllave.

Ju, zotërinjtë Vuçiq, Daçiq e Gjuriq, krijuat shumë armiq me të cilët jeni vetërrethuar! Se nga do të ecni tutje, varet shumë a do të udhëhiqeni nga njerëz me mendje të hapura apo nga njerëz me mendje të robëruara nga krimi e gjenocidi.

Po, mendjet e robëruara nga krimi e gjenocidi kanë dhënë një rezultat: Aty ku jeni degdisur! Mesjetarë të vonuar! Sa më parë që ta kuptojë këtë populli fqinj serb, aq më afër është perspektiva e përbashkët evropiane.

# Zhbllokohet xhirollogaria e Telekomit

PRISHTINË, 28 KORRIK (ER)- "Llogaritë bankare të Telekomit të Kosovës u zhbllokuan", njoftoi të martën ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi. Përmes një postimi në "Facebook", Kuçi paralajmëroi se rikthimi i tyre në normalitet do të ndodhë të mërkurën. "Pas shumë përpjekjeve, sot arritëm pajtimin për zhbllokimin e llogarive të Telekomit të Kosovës. Nga nesër llogaritë do t'i kthehen normalitetit dhe jemi të përkushtuar që Telekomi i Kosovës të operojë me performancë të lartë", ka shkruar Kuçi, duke mos dhënë hollësi të tjera.

Llogaritë bankare të Telekomit u bllokuan më 15 korrik për shkak të rastit të një arbitrazhi ndërkombëtar me kompaninë 'Z-Mobile'. Telekomi dhe 'Z-Mobile' prej kohësh kanë qenë në mosmarrëveshje për shkak të një kontrate të nënshkruar më shumë se dhjetë vjet më parë. Është vlerësuar se kjo kontratë i ka sjellë Telekomit humbje në vlerë prej 107 milionë eurosh. Ajo është ndërprerë vitin e kaluar. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës u angazhuan për gjetjen e një zgjidhjeje, për të mos lejuar falimentimin e Telekomit.




# Kafshët për kurban të blihen në ferma, therja e tyre të bëhet vetëm në thertore



PRISHTINË, 28 KORRIK (ER) - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të besimit islam, që me rastin e përmbushjes së ritit të therjes së kurbaneve, për shkak të situatës pandemike Covid-19, shitblerja e kafshëve për kurban të bëhet drejtpërdrejt nga ferma te blerësi për arsye se të gjitha lokacionet që kanë shërbyer si tregje të kafshëve janë të mbyllura dhe njëkohësisht nxjerrja e kafshëve në hapësira publike dhe grumbullimi i njerëzve është i ndaluar. "Therja e kurbaneve është obliguese dhe duhet të bëhet vetëm në thertoret e licencuara/aprovuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të cilat janë nën mbikëqyrjen zyrtare të inspektorëve veterinarë. Kafsha e cila theret për konsum mbi të gjitha duhet të jetë e kontrolluar. Andaj në thertore kontrolli kryhet para therjes, gjatë procesit të therjes dhe pas therjes, ku vlerësohet gjendja shëndetësore e kafshës dhe pas procesit të therjes, mishi i nënshtrohet kontrollit veterinar për verifikimin e përshtatshmërisë si produkt ushqimor për konsum. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të veprojnë në pajtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë dhe vendimet e qeverisë, për masat e parandalimit të përhapjes së pandemisë Covid-19", është thënë në njoftimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

# Shtatë të vdekur dhe 239 raste të reja me Covid-19

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë kanë vdekur shtatë persona nga Covid-19 dhe janë paraqitur 239 raste të reja me koronavirus. Kështu ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar se janë shëruar edhe 102 persona të tjerë nga ky virus. Në këtë kontekst, IKShPK-ja ka treguar se nga fillimi i pandemisë e deri më tani në Kosovë me Covid-19 janë prekur 7 652 qytetarë, e nga ky numër 4 129 janë shëruar dhe 192 kanë vdekur




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë vdekur shtatë persona me Covid-19 dhe janë paraqitur 239 raste të reja me koronavirus. Po ashtu, ky institut ka njoftuar se janë shëruar nga Covid-19 edhe 102 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 401 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 239 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 7 652 raste, nga 35 121 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 192 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 102 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 4 129 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 331", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se Prishtina vazhdon të prijë me numrin më të madh të të infektuarave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 82 raste, komuna Mitrovicë 27 raste, komuna Ferizaj 24 raste, komuna Drenas 17 raste, komuna Fushë Kosovë 16 raste, komuna Podujevë 14 raste, komuna Gjilan 11 raste, komuna Lipjan 8 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Shtime 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Obiliq 4 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Suharekë 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Dragash, Rahovec, Skenderaj dhe Kaçanik", ka njoftuar ky institut.

Më tutje, IKShPK-ja ka përsëritur apelin bërë qytetarëve, duke kërkuar nga ta që t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19. "Të nderuar qytetarë, virusi është kudo. Ju lutemi përmbahuni rekomandimeve. Virusi vret! Zbatimin e rekomandimeve të Institutit Kombëtar dhe Ministrisë së Shëndetësisë duhet ta bëjë çdo qytetar i Republikës së Kosovës që të ruajë veten, të afërmit dhe të tjerët. Bartja e maskave mbetet obliguese. Apelojmë te qytetarët, bizneset, gastronomia, që në mënyrë strikte ta respektojnë distancën fizike, përdorimin e maskave, dezinfektimin dhe ajrosjen e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura", ka njoftuar IKShPK-ja, duke shtuar se vendi është duke shkuar drejt një normaliteti të ri. "Ky normalitet i ri paraqet ndërrimin e sjelljeve tona për të mirë, për ta mbajtur higjienën, për ta mbajtur distancën, për ta mbajtur maskën, për të mos përhapur piklat tona të cilat i qesim nga goja çdo ditë, dikush më shumë e dikush më pak, e që rrezikojnë shëndetin e të tjerëve, por në radhë të parë shëndetin e të afërmve, të familjes, të fëmijëve, të farefisit, të komunitetit, pastaj të të gjithë qytetarëve. Inspektoratet sanitare të AUV-it dhe inspektoratet komunale bashkë me shtabet komunale patjetër duhet ta zbatojnë Ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse duke u mbështetur në manualin për luftimin e Covid-19 dhe të merren masa përgjegjësie në çdo rast të moszbatimit eventual të rekomandimeve të Institutit Kombëtar", ka njoftuar ky institut.

Sipas këtij instituti, çdo shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe jetës së të tjerëve. "Nuk ka të drejtë askush ta rrezikojë jetën e të afërmve të tyre, të moshuarve dhe personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe moszbatimit të rekomandimeve. Vazhdoni ta mbani distancën fizike dhe maskat. Lani duart me kujdes disa herë në ditë nga 20-30 sekonda. Lehtësimi i masave është bërë për të na bërë më të përgjegjshëm. Ju lutem të keni kujdes, sepse ende ekziston rreziku i përhapjes në vendet ku ka grumbullim të madh të njerëzve. Ne po punojmë për ju, andaj na ndihmoni pak që t'ju ndihmojmë shumë", ka njoftuar IKShPK-ja.

# Përfitimet dhe dëmet nga tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale



PRISHTINË, 28 KORRIK (ER) - Instituti GAP ka publikuar të martën një raport ku ka analizuar përfitimet dhe dëmet e mundshme nga tërheqja e parakohshme e kursimeve pensionale nga Trusti. "Ky raport tregon se iniciativa e qeverisë për lejimin e tërheqjes së 10 për qind të kursimeve pensionale është një metodë jokonvencionale e rritjes së kërkesës agregate në ekonomi. Kjo masë nuk mbulon personat që më së shumti kanë nevojë, si ata të papunë dhe personat e punësuar pa kontrata pune ku të ardhurat e tyre janë relativisht të vogla", është thënë në komunikatën e GAP-it.

Sipas kësaj komunikate të GAP-it, shuma e përgjithshme që mund të tërhiqet me këtë masë është rreth 200 milionë euro, mirëpo marrë parasysh që një numër i madh i qytetarëve nuk kanë kursime të mjaftueshme në Trust për ta bërë të leverdishme tërheqjen e 10 për qind të tyre, ndikimi në kërkesë agregate nuk pritet të jetë i madh. "Për më tepër, përfituesit e kësaj mase, me tërheqjen e parakohshme të kursimeve, rrezikojnë të mbesin më herët pa të ardhura gjatë kohës së pensionit. Megjithatë, pasi tërheqja e të hollave nga Trusti është paraparë të bëhet në mënyrë vullnetare, qytetarët të cilët nuk duan t'i tërheqin kursimet pensionale nuk janë të obliguar ta bëjnë një gjë të tillë", është theksuar në komunikatën e GAP-it.

Sipas GAP-it, në anën tjetër, meqenëse këto të holla nuk do të kompensohen nga shteti, zbatimi i kësaj mase nuk do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit apo në borxhin publik të Kosovës. "Mundësia e tërheqjes së kursimeve të Trustit, për një pjesë të qytetarëve mund ta lehtësojë barrën e borxhit të shkaktuar nga gjendja ekonomike e pandemisë dhe ta rrisë qarkullimin e parasë në treg edhe për personat që nuk përfitojnë nga kjo masë. Po ashtu, ekziston mundësia e punëdhënësve dhe punëmarrësve që në një të ardhme, në mënyrë vullnetare, t'i rikuperonin paratë e tërhequra në Trusti duke e rritur kontributin deri në 10 për qind të pagës së tyre vjetore. Ky raport analizon edhe aspektin e likuiditetit të vet Trustit dhe të sistemit bankar në Kosovë në rast se Kuvendi i Kosovës miraton ndryshimet ligjore për tërheqjen e parakohshme të kursimeve pensionale", është thënë në komunikatën e GAP-it.

# Ministri Krasniqi zotohet për t'i shtyrë përpara kërkesat e bizneseve




Prishtinë, 28 korrik (ER) - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një konferencë virtuale me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, në të cilën, bashkë me përfaqësues të bizneseve anëtare të kësaj ode, u diskutua për të ardhmen e ekonomisë së Kosovës pas pandemisë Covid-19 si dhe për planifikimet e qeverisë për mbështetje ndaj sektorit privat.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka theksuar nevojën për miratim të buxhetit dhe projektligjit për rimëkëmbje ekonomike, mungesa e të cilave po vazhdon të shkaktojë stagnimin e rimëkëmbjes.

Zeka ka potencuar rëndësinë e investitorëve strategjikë dhe investimeve të huaja të cilat janë vitale për ta siguruar zhvillimin ekonomik të vendit derisa rekomandoi ministrinë t'i rishqyrtojë me prioritet aplikacionet e investitorëve strategjikë.

Ministri Vesel Krasniqi ka thënë se, me gjithë dëshirën për lejim të veprimtarive ekonomike, si pasojë e ngritjes së numrit të infektimeve me Covid-19 situata është rënduar dhe ka qenë e domosdoshme që të merren masat e nevojshme. Ai ka theksuar se për implementim sa më të mirë të masave janë krijuar udhëzimet administrative në përputhje me rekomandimet e institucioneve shëndetësore dhe se janë krijuar grupe për inspektimin e veprimtarive dhe respektimin e masave mbrojtëse brenda sektorit të gastronomisë.

Ministri Krasniqi ka shtuar se rishikimi i buxhetit dhe finalizimi projektligjit për rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës janë në fazat finale të procesimit në Kuvend, derisa potencoi se pas miratimit të këtyre projektligjeve brenda një afati të shkurtër kohor do t'i hapet rrugë implementimit të Pakos Emergjente Fiskale dhe asaj për rimëkëmbje ekonomike.

Më tutje, ministri gjithashtu foli për çështjen e investimeve strategjike, ku tha se aprovimi i statusit të investitorit strategjik është zvarritur për shkak të vakuumeve institucionale dhe është i dhimbshëm fakti se deri më tani këtë status e gëzojnë vetëm dy kompani, sepse në këtë mënyrë investitorët potencialë mund t'i konsiderojnë shtetet fqinje në vend të Kosovës në një kohë kur çdo investim është i nevojshëm.

# Haziri pret Kuçin, konfirmohen investimet në projektet madhore në të mirë të gjilanasve




Gjilan, 28 korrik (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim pune ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuqi, dhe ku bashkërisht janë konfirmuar projekte të ndryshme për investim në Gjilan, konkretisht investimin e projektit të lumit Mirusha-jug, pastaj investimet në efiçiencë në objektet arsimore dhe objekte të tjera administrative.

Kryetari Haziri, në konferencën për media, tha se e ka njoftuar ministrin për të gjitha zhvillimet dhe angazhimet e përbashkëta në nivelin lokal në përballimin e situatës me Covid-19 dhe shëndetin ekonomik, gjithashtu. "E njoftova ministrin për të gjitha zhvillimet, përballjen me pandeminë, gjendjen ekonomike në këtë periudhë dhe procesin e investimeve që janë duke u realizuar dhe atyre që janë në planifikim. Shpresojmë shumë për mbështetjen e qeverisë dhe të ministrisë së linjës në këtë fazë, sepse janë të domosdoshme zhvillimet e projekteve, sikur edhe përballimi i gjendjes me pandeminë. Projekti për impiantin e ujërave të zeza përfundimisht është ratifikuar në Kuvendin e Republikës, pastaj lumi Mirusha, ku janë duke u realizuar punimet në pjesën veriore dhe konfirmimin nga ministri për mbështetje të projektit në pjesën jugore. Zotimi për mbështetje në efiçiencë, parqe publike, trajtimin e lumenjve dhe projekte madhore tashmë janë pjesë e ministrisë", ka thënë kryetari Haziri.

Ministri Kuçi ka potencuar rëndësinë e madhe që ka aprovimi i tri ligjeve sikur që është ai për rishikimin buxhetor, pastaj Ligji për rimëkëmbje ekonomike dhe Ligji për menaxhimin e virusit Covid-19. "Këto janë tri ligje të rëndësisë esenciale. Në rast se këto tri ligje nuk kalojnë, Kosova do të futet në kolaps. Janë ligje që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm qytetar, me mbështetje të sektorit privat, ndikimin në qëndrueshmërinë ekonomike, të bizneseve, ndërmarrjeve publike dhe punëtorëve në përgjithësi, por edhe mbështetjen e qytetarëve përmes formave të ndryshme. Gjithashtu, marrëveshja për impiantin e ujërave të zeza dhe kolektorëve tashmë ka kaluar dhe presim hapa të tjerë të fillimit të projektit. Njëkohësisht nga Gjilani njoftoi se jemi duke punuar me Bankën Botërore për projektin tjetër në ndërtimin e liqenit akumulues që do ta zgjidhë problemin afatgjatë të furnizimit me ujë të pijshëm, që planifikohet të ndërtohet në Kremenatë, në një vlerë prej rreth 70 milionë eurosh deri në përfundimin e tërësishëm të tij", ka thënë ministri Kuçi.

# Njohësit e ekonomisë vendore, optimistë për rimëkëmbjen ekonomike të Kosovës



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 28 korrik - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një forum virtual, ku është diskutuar mbi perspektivat për rimëkëmbje ekonomike dhe hapat të cilët duhet të ndërmerren për të siguruar të ardhmen e bizneseve në industri të ndryshme, si dhe evitimin e një krize më të thellë ekonomike e cila do ta shkaktonte falimentimin e shumë bizneseve të sektorit privat, veçanërisht të atyre të vogla dhe të mesme.

Financimi për këtë forum virtual u mbështet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe programi i BE-së për Zhvillim të Ndërmarrjeve dhe Lehtësim të Investimeve.

Michael Gold, drejtor menaxhues në kompaninë "Crimson Capital", ka theksuar se shumica e programeve të vendosura nga qeveria, por edhe përkrahja nga donatorët ndërkombëtarë janë mjaftë pozitive për ekonominë e vendit, megjithatë vonesat në implementim e tyre vetëm se rrisin dëmet e shkaktuara. Sipas Gold, për t'i trajtuar problemet e bizneseve me likuiditet është mirë të inkurajohet përdorimi i instrumenteve financiare jotradicionale siç janë, mes të tjerash, faktoringu dhe lizingu, për të cilat rëndomë bizneset nuk janë as të vetëdijshme derisa ekziston edhe korniza ligjore për përdorim të tyre.

Sipas Gold, për të siguruar rimëkëmbje ekonomike Qeveria e Kosovës duhet t'i japë rëndësi menaxhimit të duhur shëndetësor të pandemisë dhe marrjes së masave për zhvillimin e sektorëve më të ndikuar. Ai shprehu optimizëm për rimëkëmbjen ekonomike të vendit nëse të gjithë hisedarët japin kontributin e tyre dhe problemet me pandeminë tejkalohen, derisa tha se sektorët si ai i TIK-ut, financave dhe bujqësisë kanë mundësi të mira të fuqizohen.

Leonora Kusari, menaxhere kryesore në Departamentin Këshilla për Biznese të Vogla në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, u shpreh e shqetësuar mbi mosveprimin e institucioneve dhe vonesën e implementimit të masave të nevojshme për ta mbështetur sektorin privat, duke theksuar se ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë veçanërisht të rrezikuara për mbijetesë në këtë kohë. Sipas Kusarit, qeveria duhet të reagojë me programe specifike mbështetëse që targetojnë sektorët e veçantë. Ajo theksoi se sektori i shërbimeve që ndërlidh në vete shumë biznese të vogla është ndër më të ndikuarit. Ajo u shpreh se ekziston nevojë për përzierje të instrumenteve të ndryshme financiare dhe krijim të incentivave që inkurajojnë investime, duke përfshirë grantet. Ajo tha se jo vetëm proceset e bizneseve, por edhe ato të qeverisë duhet të digjitalizohen urgjentisht. Kusari potencoi se BERZh-i ka mjaft instrumente të cilat po mundohet t'i vë në përdorim, mirëpo nuk është se po has në kërkesë të tregut për të njëjtat, me ç'rast ritheksoi nevojën për edukim të bizneseve mbi instrumentet e ndryshme financiare që ekzistojnë në vend. Ajo tha se bizneset e Kosovës gjithmonë kanë luftuar për të mbijetuar pa u varur nga ndihma e qeverisë, por tash është koha që kjo e fundit të ofrojë përkrahje, derisa u shpreh se beson fuqishëm në rimëkëmbjen ekonomike të vendit.

Besa Ilazi, specialiste për menaxhim të projekteve në zyrën e USAID-it për rritje ekonomike, theksoi se edhe para shpërthimit të pandemisë në Kosovë një ndër problemet më të mëdha me të cilin është raportuar se përballeshin qytetarët ishte papunësia, andaj situata aktuale vetëm se e ka përkeqësuar këtë fenomen. Ilazi theksoi se nga këndvështrimi i USAID-it, shumë ndërmarrjeve duhet t'u ofrohet asistencë në mënyrë që të shmanget falimentimi i tyre. Ilazi potencoi rëndësinë e borxhit publik në këtë situatë kritike, sidomos duke e marrë parasysh se vendi nuk ka politika monetare, ku tha se qeveria duhet të fokusohet në mënyrat më të mira për ta arritur rimëkëmbjen ekonomike. Sipas saj, çdo lloj zhvillimi për rimëkëmbjen ekonomike pa menaxhim të mirëfilltë të krizës shëndetësore do të jetë i pakuptimtë, prandaj të dyja duhet të ndodhin paralelisht. Për fund, Ilazi tha se është e paevitueshme përshtatja ndaj këtij ambienti të ri, andaj ajo është mjaft pozitive për rimëkëmbjen ekonomike të vendit.

## KMDLNj-ja bën thirrje të votohet rishikimi i buxhetit

Prishtinë, 28 korrik (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) u ka bërë thirrje deputetëve që ta votojnë rishikimin e buxhetit. Po ashtu, KMDLNj-ja ka bërë thirrje për bashkim në luftën kudër Covid-19. "Qytetarët e Kosovës janë në gjendje të rëndë për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19. Me përshkallëzimin e rasteve që janë prekur nga virusi, si dhe me rritjen e numrit që përfundojnë me fatalitet, Kosova qëndron më së keqi në rajon. Madje, krahasuar me numrin e banorëve, është në majat e vendeve më të prekura në botë.




Pandemia e shkaktuar nga Covid-19, për shkak të masave shtrënguese të vendosura nga Qeveria e Kosovës, e ka thelluar gjendjen edhe ashtu të rënduar ekonomike, duke i vënë para falimentimit shumicën e bizneseve. Deputetët e Kosovës, një numër i tyre ekskluzivisht të motivuar edhe për shkaqe politike, deri më tani nuk po pajtohen ta votojnë buxhetin e rishikuar, ndërkohë që kanë votuar marrëveshjet ndërkombëtare. Në kohën kur punëtorët shëndetësorë po bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme për ta shpëtuar jetën e të prekurve nga virusi, në kushtet që i tejkalojnë kapacitetet fizike dhe të vendosjes, një pjesë e deputetëve që pas betimit të dhënë nuk do të duhej të ishin vetëm deputetë të subjektit që e përfaqësojnë, por në funksion dhe shërbim të të gjithë qytetarëve, po hezitojnë ta votojnë buxhetin e rishikuar, duke ua vështirësuar edhe më shumë gjendjen shumicës së qytetarëve të Kosovës si në aspektin shëndetësor, po ashtu edhe material", është thënë në komunikatën e KMDLNj-së, duke theksuar më tutje se është përgjegjësi tepër e madhe nëse në këtë situatë nuk votohet buxheti i rishikuar që, sipas KMDLNj-së, ky buxhet është me shumë të meta. "Megjithatë, është një infuzion për mbijetesë për një pjesë të madhe të qytetarëve të Kosovës si dhe për krijimin e kushteve për rimëkëmbje të ekonomisë", theksohet në komunikatën e KMDLNj-së.

# Prishtinës pritet t'i shtohen tri shkolla të reja




PRISHTINË, 28 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka njoftuar se kanë filluar procedurat tenderuese për tri shkolla të reja. Ahmeti ka treguar se shkollat e reja do të ndërtohen në lagjen "Mati 1", "Sofali" dhe lagjen "Qëndresa" në Veternik. "Dje ka dalë njoftimi për fillimin e procedurave të tenderimit për tri shkolla të reja në Prishtinë, në 'Mat', 'Sofali' e 'Veternik' (afër lagjes 'Qëndresa'). Pas një vlerësimi mjedisor së shpejti edhe për shkollën e katërt në 'Arbëri', afër Komunës së Re. Këto katër shkolla po bëhen në bashkëpunim me IFC (Banka Botërore) dhe për herë të parë në Kosovë me metodën PFI (Private Finance Initiative). Shkollat janë dizajnuar nga një kompania italiane-kolumbiane, e përzgjedhur nga Banka Botërore dhe do të jenë ndër shkollat më moderne në Kosovë. Faza e parë e tenderimit është para kualifikimi, ku pastaj kompanitë që i kalojnë kushtet do të ftohen për të ofertuar. Me këtë e kompletojmë rrjetin primar të shkollave", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Përfundon projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Karaçevë e Epërme



KAMENICË, 28 KORRIK (ER) - Komuna e Kamenicës ka njoftuar se ka përfunduar projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Karaçevë e Epërme të kësaj komune. Ky pilotprojekt është financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bashkëpunim me Komunën e Kamenicës. Projekti në fjalë ka arritur vlerën afër 130 mijë eurove. Me këtë rast, kryetari Qëndron Kastrati, duke uruar banorët e fshatit Karaçevë, ka thënë se do ta vazhdojë punën për qytetarët e Komunës së Kamenicës. "Ka përfunduar projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Karaçevë e Epërme. Gjatë kësaj qeverisjeje dora e institucionit është shtrirë edhe në fshatra, por normalisht se kemi akoma punë duke pasur parasysh shtrirjen territoriale që ka komuna jonë. Urime banorëve të Karaçevës! Vazhdojmë punën për qytetarët tanë", ka thënë Kastrati.

# Filloi rregullimi i rrugëve në Drenoc të Malishevës

MALISHEVË, 28 KORRIK (ER) - Në fshatin Drenoc, i cili është një prej fshatrave më të mëdhenj të Komunës së Malishevës, ka filluar rregullimi i dy rrugëve me gjatësi prej 700 metrave në lagjet e këtij fshati. Në fillimin e punimeve ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina dhe ai i Shërbimeve Publike, Milazim Morina.
Punimet filluan në rrugën "Sharri", e gjatë 550 metra. Drejtorët e drejtorive përkatëse janë pritur nga kryetari i fshatit Nehat Krasniqi dhe nga qytetarët e tjerë.
Drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, i ka uruar banorët për rrugët, ndërsa ka thënë se "ky investim është pjesë e realizimit të projekteve kapitale, përkatësisht e rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në Komunën e Malishevës dhe në fshatin Drenoc". Sipas Morinës, edhe kjo rrugë mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.
Në emër të fshatit Drenoc, kryetari i fshatit, Nehat Krasniqi, e ka falënderuar komunën për këtë investim me rëndësi për banorët. "Ne jemi duke bashkëpunuar mirë me komunën dhe përmes këtij bashkëpunimi po arrijmë t'i realizojmë disa prej nevojave që kanë banorët e fshatit Drenoc", ka thënë kryetari i Drenocit, Nehat Krasniqi.





# Fshati Rakaj së shpejti me infrastrukturë rrugore të kompletuar

FERIZAJ, 28 KORRIK (ER) - Komuna e Ferizajt ka njoftuar se fshati Rakaj së shpejti do të bëhet me infrastrukturë rrugore të kompletuar. "Ky projekt parasheh asfaltimin e rrugëve me gjatësi mbi 6 kilometra, rregullimin e 400 metrave kanalizim fekal dhe 150 metër kanal atmosferik", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Punimet në projektin për rregullimin e infrastrukturës rrugore në këtë fshat i ka inspektuar të martën drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyqi, bashkë me nënkryetarin e Komunës së Ferizajt, Arton Gavazi.
Bytyqi ka thënë se ky projekt ka një rëndësi jetike për banorët dhe së shpejti do t'i japë rezultatet pozitive për banorët e fshatit Rakaj.

# JA SI FLET SERBIA (19)



Shkruan: Kudusi LAMA

Në librin në fjalë "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "SEKRETE",[1] është thirrur në ndihmë edhe perëndia, sikur ajo është vetëm e serbëve. Në faqen e parë të librit shkruhet:

"Kush nuk vjen në luftë në Kosovë - prej dorës së tij asgjë nuk do prodhoj:
as në fushë grurë të bardhë,
as në mal hardhi të rrushit!"
Mallkimi i princit të shenjtë - Llazarit[2]

A është arsyetimi i këtij mallkimi raporti i atij të quajturi Dick Marty, që i paskan prishur shumë punë shqiptarët dhe që qenkan shkas për kriminalitet në rajon? I cili paska gjetur mundësinë të flasë në emër të Evropës për të goditur si do ai me ustallarët e tij serbë. Sa i vogël bëhet njeriu kur bëhet skllav i të tjerëve, fat i keq e ka gjetur të ziun Dick Marty.

Në vazhdim le të evidencojmë se çfarë thonë serbët në këtë libër: "Terrorizmi shqiptar në Kosovë e Metohi, si dhe në komunat e Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës, i lidhur me forma të shumëllojshme me krimin e organizuar, paraqet një rrezik të vazhdueshëm për sigurinë e qytetarëve dhe stabilitetin politik jo vetëm të vendit tonë, por edhe të shteteve të tjera në rajon. (Edhe pse në Komunën e Medvegjës popullsia shqiptare nuk përbën shumicën, ekstremistët shqiptarë e trajtojnë atë si një pjesë të vetme territori etnik). Bartësit e një veprimtarie të tillë kanë për qëllim ta sigurojnë legalizimin e veprimtarive të tyre kriminale dhe të pasurisë së fituar, ta arrijnë krijimin e Shqipërisë së Madhe ose të Kosovës së Madhe, në mënyrë që ta rrethojnë territorin që e konsiderojnë si hapësirë etnike shqiptare dhe ta zgjerojnë tregun e tyre të brendshëm dhe, në mënyrë të ndërsjellë, fuqinë e vet ekonomike, të krijojnë ndikim politik dhe pjesëmarrjen në organet më të larta të pushtetit në këtë territor. Nxitja e dhunës dhe krijimi i vazhdueshëm i pastabilitetit në Ballkan mundëson që skenari i nxitur të realizohet në mënyrë sa më të efektshme".[3]

Kur bëhet krahasimi i terminologjisë së përdorur në këtë libër dhe asaj të përdorur në raportin e Dick Martyt, duket menjëherë ngjashmëria ose, thënë më mirë, binjakëzimi midis këtyre të dy deklarimeve megjithëse njëri është i Serbisë e tjetri i Bashkimit Evropian. "Pasi vendosën lidhjen me strukturat kriminalistike, bartësit e veprimtarisë terroriste fuqizuan pozitën e tyre politike të cilën e shfrytëzojnë për presion mbi tërë popullsinë shqiptare, si dhe mbi subjektet politike autoktone shqiptare, duke i detyruar ata për bashkëpunim dhe koncensione. Kështu në opinionin publik arrihet përshtypja për një homogjenitet të plotë të korpusit kombëtar shqiptar dhe të interesimit të tij të vetëm për të njëjtin qëllim. Megjithatë, prapa motiveve ideopolitike e kombëtare për krijimin e një shteti shqiptar të vetëm, pavarësisht nga se ai quhet Shqipëria e Madhe apo Kosova e Madhe, fshihen interesa të caktuara të strukturave kriminale, të cilat synojnë që të përfshihen në proceset ekzistuese të tranzicionit politik dhe ekonomik, përkatësisht të transformimit të rajonit në tërësi, si dhe t'i legalizojnë punët e tyre kriminale".[4]

Duket pra, se shqetësimi edhe i Serbisë edhe i zotëri Martyt është i njëjtë, të dyja palët janë shumë të shqetësuar se po u kriminalizohet rajoni, pasi shqiptarët kanë kundërshtuar me armë kolonizimin serb mbi territoret e atdheut të tyre. Ata janë shumë të shqetësuar, veç të tjerave, edhe pse shqiptarët në përgjithësi qenkan të mashtruar prej luftëtarëve, të cilët duke u folur për çështjen kombëtare, në fakt nuk paskan qëllim këtë por, thjesht, të sigurojnë pushtet për veten e tyre që ta zgjerojnë sferën e kriminalitetit. Që serbët do të flasin me këtë gjuhë është e qartë dhe nuk na krijon ndonjë befasi, por që zotëri Marty ka të njëjtin shqetësim, duket si anakronizëm. Serbët me këtë fjalor kanë folur edhe për Hasan Prishtinën, Isa Boletinin, Bajram Currin, Azem Galicën, Shaban Polluzhën e tani edhe për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç do të flasin edhe për të gjithë veprimtarët kombëtarë në të ardhmen, siç kanë folur edhe për të gjithë ata burra e gra të Kosovës e të trojeve shqiptare të pushtuara, të cilët i kanë burgosur, torturuar, masakruar e shfarosur prej një shekulli. Shqiptarët e dinë mirë këtë. Ndërsa që të quhen kriminelë pse kërkojnë lirinë prej të dërguarve të Evropës, ndihen si të ishin të tradhtuar pse duan vatrat e tyre të lira. "Shqiptarët, veçmas nga Kosova e Metohia, kanë zhvilluar ndjenjën e identitetit kolektiv, i cili është parakusht i domosdoshëm për t'u marrë me krimin e organizuar. Në të vërtetë ky element, i bazuar në përkatshmërinë e një grupi të caktuar, ka lidhur krimin e organizuar shqiptar me idealet mbarëshqiptare, me politikën, me veprimtaritë ushtarake dhe me terrorizmin".[5]

Këtë formulë zotëri Marty e ka trajtuar si besnikëri klanore. Nëse serbët e trajtojnë si një ndjenjë identiteti kolektiv, që bëhet pengesë të depërtojnë serbët në strukturat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zotëri Martyn e pengon besnikëria klanore të depërtojë për t'i gjetur kriminelët e për t'i vënë në bankën e të akuzuarve. Por, megjithatë, ai nuk e ka shumë problem, pasi duke supozuar i përcakton me emër e mbiemër ata që i konsideron udhëheqësit e kriminelëve, që nuk paskan bërë asgjë me vlerë, veçse janë marrë me krime dhe kanë shkaktuar shumë probleme, që tashmë kanë takuar në ustain - Dick Marty, i cili do t'i zbërthej deri në një për ta gjetur të "vërtetën" që i mungon sipas qëllimit që i ka vënë vetes në raportin e paraqitur në Këshillin e Evropës, që është përpiluar e trajtohet sipas instruksioneve dhe detyrave të Serbisë e në shërbim të saj.

Pra, në konkluzion të këtij paragrafi të cituar duket se, nëse lufton kundër Serbisë, nuk je tjetër veçse kriminel dhe terrorist. Të njëjtën etiketë na vë edhe zotëri Marty në raportin e tij. "Modelin universal relativisht të funksionimit të terrorizmit në botë, i cili, si rregull, në pjesën më të madhe financohet nga burime kriminale, me të ardhurat nga kontrabanda e drogës, e armëve, e njerëzve dhe e mallit të hyrë (akcizë), zbatoi, në kohën e vet, udhëheqja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)", kurse tani këtë e bëjnë edhe udhëheqësit e ushtrisë kombëtare shqiptare. (Është fjala për UÇPMB-në dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare - KL). Në këtë mënyrë është realizuar derdhja e papenguar dhe e vazhdueshme e mjeteve për aktivitetet terroriste, kurse personalitetet udhëheqëse të UÇK-së dhe të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, si dhe patriotët shqiptarë më në zë, për një kohë të shkurtër, arritën deri në pasurinë vetjake shumë të madhe, në kushtet e një krize social-ekonomike të thellë e shumë të zgjatur në rajon. Kjo është nxitja e vazhdueshme e zgjerimit të veprimtarive kriminale, të cilat, edhe më tej, paraqesin burimin e pashtershëm të të ashtuquajturave para të pista, si baza për sigurimin e vazhdueshmërisë së veprimtarive terroriste dhe të rekrutimit të përhershëm të luftëtarëve të rinj".[6]

Na e ka gjetur modelin e financimit Serbia për ta bërë luftën për çlirimin prej pushtimit të saj. Na e ka përcaktuar se shqiptarët nuk mund të kishin bërë luftë po të mos merreshin me kontrabandën e drogës, të njerëzve, të armëve dhe të gjithë të këqijave që njihen në organet dhe organizatat e krimit në botë. Lexojeni raportin e zotit Marty, i cili nuk bën tjetër veçse duke ardhur në terren në një kohë edhe gjashtë vjet më vonë se të shkruhej ky libër, i specifikon më tej krimet e shqiptarëve, duke i saktësuar sikur të ishte duke vepruar në shkretëtirë jo në një vend të banuar e të qytetëruar, me njerëz të shkolluar e me ndërgjegje kombëtare bashkëkohore. Ai arrin të vërë edhe emra të adresave se nga është bërë lëvizja e gjithë këtij kriminaliteti.

Siç del nga ky citim, duket se shqiptarët gjithë pasurinë përpiqen ta grumbullojnë vetëm që të ndërtojnë, nxitin e funksionalizojnë terrorizmin. Ndërsa, në fakt, shqiptarët e dinë mirë se në gjenin e tyre nuk ka asnjë dukuri terroriste, nuk ka asnjë moment kur shqiptarët të jenë bërë pjesë e organizimeve apo të organizatave terroriste. Ashtu sikurse nuk mund të flitet për organizime të tilla në frontet e luftës, kur nuk ka as bukë për t'i plotësuar nevojat e organizmit në masën e duhur. Por qëllimi i këtyre citimeve nuk është të bëjmë vlerësime të detajuara. Atë ndoshta do ta bëjmë a duhet ta bëjmë në një kohë më të vonë. Kurse në këtë reagim qëllimi i vetëm është ta vlerësojmë terminologjinë e përdorur dhe adresimet në të dy materialet, në atë të Serbisë dhe në raportin e Dick Martyt, duke vënë në evidencë ngjashmëritë midis tyre, për të parë se sa besnik i Serbisë është zotëri Marty dhe sa poshtë bien organizatat ndërkombëtare duke e marrë seriozisht atë, pa paraqitur argumente. "Specifika e modelit të përbashkët të organizimit të strukturave terroriste dhe kriminale shqiptare është respektimi i parimeve të ndarjes territoriale me marrjen parasysh të sferave të interesave dhe të zonave të ndikimit të familjeve të caktuara. Në përputhje me këtë, në çdonjërin nga grupimet e përmendura, anëtarësia bazë i përket fisit përkatësisht, familjes së gjerë, e cila është mbizotëruese e përfaqësimit në territorin e caktuar. (Kështu, p. Sh., në Drenicë mbizotërojnë familjet Gecaj, Kodra, Jashari, Selimi dhe shumica e pjesëtarëve të UÇK-së nga kjo zonë dolën pikërisht nga këto familje)".[7]

Nuk përtojnë serbët të na e parcelizojnë përgjegjësinë terroriste e kriminale deri në familje, por më i thellë është zotëri Marty sepse ai na e individualizon duke na i grupuar këto familje në "Grupin e Drenicës" dhe duke na i caktuar edhe "kumbarin" me emër e mbiemër. "Ndarja e përpiktë territoriale dhe klanore e pjesës më të madhe të shoqërisë shqiptare i kontribuon ruajtjes së organizimit tradicional hierarkik, mbylljes së tij dhe disiplinës së brendshme të rreptë të pjesëtarëve, e cila edhe sot zbaton vënien në jetë të ligjit (kanunit) të zakonshëm të Lekë Dukagjinit, ose sipas nderit të kodit klanor. Kërcënimi i kryerjes së detyruar të gjakmarrjes në rast tradhtie ose thyerjes së marrëveshjes u siguron mbrojtje të plotë zbatuesve të akteve terroriste e kriminale dhe, njëkohësisht, paraqet motivin më të shpeshtë të vrasjes midis pjesëtarëve të popullsisë shqiptare".

Ashtu si zotëri Marty më vonë, pra në vitin 2010, serbët që më 2004 na kanë zbuluar se në klanet kriminale shqiptare ekziston një kanun, që serbët e evidencojnë edhe si kanuni i Lekë Dukagjinit, që paska ligjësi të cilat ndëshkojnë tradhtinë dhe që mban rregull në grupet e familjet dhe fiset shqiptare. Ky është një monstruozitet i veçantë, që jo vetëm serbët, por edhe zotëri Marty na e kthen kanunin tonë, që është kryevepër ligjore, zakonore, kulturore dhe historike, në një ligjësi kriminaliteti. Kanuni i Lekë Dukagjinit është një ligj i lashtë, që kur ai vendoste ligje shoqërore të barazisë, në Evropën e zotëri Martyt i dënonin njerëzit duke i vendosur e djegur nëpër turra drush, duke u prerë gjymtyrët e duke u prerë kokën. Ndërsa për serbët duhet thënë se ata e dinë mirë, se kur shqiptarët zbatonin këtë ligj drejtësie, ata nuk kishin as fise të organizuara. Megjithatë duhet sqaruar se në kanun ka nene të plota që ndëshkojnë çdo krim, përfshi edhe ata që duan t'ua veshin shqiptarëve serbët dhe megafoni i Serbisë - Dick Marty. Lexojeni kanunin ju serbët dhe Ju zotëri Marty, të kuptoni se aty lejohet të bëhen vetëm vepra ndershmërie e atdhetarie, ndërsa të gjitha veprat e tjera kriminale dhe të turpshme ndëshkohen rreptë. Unë e kuptoj që ju jeni të dy palët për të ardhur keq, por realisht me këtë intensitetin e shpifjeve, po i dëmtoni shqiptarët në opinionin e gjerë botëror, pasi askush nuk ka mendjen tuaj të kuptoj se ju po shpifni. Bota mendon se jeni qytetar, ajo nuk e di se ju akoma keni mbetur në mesjetë me mendësitë dhe praktikat që zbatoni në marrëdhëniet me të tjerët e në veçanti me shqiptarët, në territoret e të cilëve edhe jeni shtrirë deri sot e jeni bërë me atdhe. *(Vijon)*

---

1 Libri i Millosh Obiliçit, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "sekrete", është përkthyer në shqip me kërkesën time nga profesor doktor Hasani Çipuri, i cili është njohës shumë i mirë i serbishtes dhe autor i një seri fjalorësh në këtë gjuhë.

2 Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 1, botimi serbisht

3 Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 7, botimi serbisht

4 Obiliç Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 7-8, botimi serbisht

5 Po aty faqe 8

6 Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 8, botimi serbisht

7 Obiliç Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", dosjet "sekrete", Beograd, 2004, faqe 8, botimi serbisht

# Covid-19, vaksina eksperimentale hyn në fazën e fundit

**Nju Jork, 28 korrik -** Prova më e madhe deri më sot e një vaksine eksperimentale për Covid-19 filloi të hënën me të parët e një grupi prej gati 30 000 amerikanësh që përveshën mëngët për ta marrë vaksinën e krijuar nga qeveria amerikane si pjesë e garës gjithëpërfshirëse globale për ta ndaluar shpërthimin e virusit vdekjeprurës.

Testimi në fazën përfundimtare të vaksinës, zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë dhe kompania "Moderna Inc.", filloi me vullnetarë në qendra të shumta amerikane duke u dhënë një dozë të vërtetë të vaksinës ose thjesht një injektim false. "Po marrë pjesë në testim pasi jam një punonjëse e kujdesit shëndetësor në pension dhe i kuptoj mirë sfidat që Covid-19 i ka shkaktuar komunitetit, shtetit dhe gjithë vendit", ka thënë pjesëmarrësja Karen Juser, e cila mori injeksionin në Binghemton të Nju Jorkut.

Do të kalojnë disa muaj përpara se të merren rezultatet dhe nuk ka asnjë garanci që vaksina përfundimisht do të funksionojë kundër virusit që ka vrarë rreth 650 000 njerëz në të gjithë botën, përfshirë gati 150 000 në ShBA.

Shkencëtarët vendosën rekorde të shpejtësisë për zhvillimin e vaksinës me një provë kaq masive vetëm disa muaj pas




shfaqjes së koronavirusit. Por ata theksuan se publiku nuk duhet të frikësohet se vaksina nuk është e sigurt. "Ky është një moment historik domethënës", ka thënë drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, Francis Collins, pasi u dha injeksioni i parë i provës.

Pasi vullnetarët të marrin dy doza një muaj larg njëra-tjetrës, shkencëtarët do të ndjekin nga afër për të par` se cili grup përjeton më shumë infeksione, ndërsa vazhdojnë rutinën e tyre të përditshme, veçanërisht në zonat ku virusi po përhapet pa kontroll.

Disa vaksina të tjera të zhvilluara nga Kina dhe nga Universiteti i Oksfordit në Britani filluan prova më të vogla në fazën përfundimtare në Brazil dhe vende të tjera të goditura në fillim të këtij muaji.

# Johnsoni: Ka shenja të 'valës së dytë' të pandemisë në Evropë

**Londër, 28 korrik -** Kryeministri britanik Boris Johnson e mbrojti vendimin e qeverisë së tij për t'i futur në karantinë udhëtarët që vijnë nga Spanja, duke thënë se "ka shenja të valës së dytë të koronavirusit" në disa pjesë të Evropës. "Ajo që duhet të bëjmë është të ndërmarrim veprime të shpejta, kur mendojmë se rreziqet kanë filluar të rriten sërish", tha Johsnon.

Ai shtoi se individët duhet të vendosin vetë nëse duan të rrezikojnë dhe të shkojnë jashtë vendit në rrethanat aktuale. "Le të jemi plotësisht të qartë për atë që po ndodh në Evropë, në mesin e disa miqve tanë evropianë. Unë druaj se në disa vende kanë nisur të shihen shenjat e valës së dytë të pandemisë", tha Johnson.

Komentet vijnë pasi kryeministri i Spanjës, Pedro Sanchez, tha se vendimi i Mbretërisë së Bashkuar për t'i ndryshuar rregullat për Spanjën, është i padrejtë.

Qeveria në Londër vendosi këtë javë që udhëtarët që kthehen në Mbretërinë e Bashkuar nga Spanja, duhet të vetizolohen për 14 ditë në një adresë të regjistruar.

Vendimi i ri u tha se u mor pas rritjes së numrit të rasteve të reja me koronavirus në Spanjë. Por, Sanchez tha se turistët në shumicën e rajoneve në Spanjë do të ishin më të sigurt nga koronavirusi sesa në Mbretërinë e Bashkuar.

Edhe Gjermania i këshilloi të martën shtetasit e saj që ta shmangin udhëtimin në tri zona të Spanjës. Në Evropë, aktualisht, Mbretëria e Bashkuar prin me numër të rasteve me koronavirus: mbi 301 000. Pas saj vjen Spanja me mbi 278 000.

Ekspertët shëndetësorë nuk kanë ndonjë përkufizim formal për valën e dytë të koronavirusit, por valë e re konsiderohet situata kur numri i të infektuarve bie për një kohë dhe pastaj rritet sërish.



# ShBA: Republikanët prezantojnë planin për rimëkëmbje nga pandemia



**Uashington, 28 korrik -** Republikanët në Shtetet e Bashkuara kanë propozuar në Senat një paketë të re të ndihmës për koronavirus në vlerë të 1 trilion dollarëve ashtu që t'u ndihmojnë amerikanëve ta përballojnë papunësinë dhe pasojat e tjera që ka shkaktuar pandemia me koronavirus.

Lideri i shumicës në Senat, republikani Mitch McConnell, e ka cilësuar propozimin plan "të shënjestruar", i cili synon t'i kthejë njerëzit në punë si dhe t'i hapë shkollat. "Ne jemi me një këmbë në pandemi dhe me një tjetër në rimëkëmbje. Populli amerikan i duhet më shumë ndihmë. Ajo duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe duhet të jetë e përshtatshme në këtë udhëkryq", ka thënë McConnell.

Republikanët janë konsultuar edhe me Shtëpinë e Bardhë për këtë plan dhe tani synojnë të arrijnë kompromis me demokratët.

Ligjvënësit janë nën presion për t'iu përgjigjur miliona amerikanëve të shqetësuar, të cilëve më 31 korrik iu skadon mundësia e marrjes së përfitimeve nga qeveria federale. Plani i ri synon të ulë këto përfitime nga 600 në 200 dollarë në javë.

Demokratët kanë kritikuar menjëherë planin, duke e cilësuar si shumë të kufizuar dhe larg propozimit prej 3 trilionë dollarëve, që është miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve në muajin maj.

Këtë të fundit, Senati i kontrolluar nga republikanët, ka refuzuar që ta shqyrtojë.

Qeveria amerikane deri më tani ka shpenzuar 3.7 trilionë dollarë për mbrojtje të ekonomisë së dëmtuar si pasojë e mbylljes së bizneseve dhe urdhrave për qëndrim në shtëpi, me qëllim të luftimit të sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusi i ri.

## Haxhillëku përmes realitetit virtual në kohën e koronavirusit

Mekë, 28 korrik - Për herë të parë në historinë e Arabisë Saudite nuk do të ketë pelegrinë të huaj që do të vijnë për haxhillëk si rrjedhojë e kufizimeve që ka bërë të nevojshme pandemia. Në këtë situatë, një studio e produksioneve grafike në Gjermani ka krijuar një program kompjuterik që u lejon besimtarëve myslimanë ta ndjekin haxhillëkun virtual.

Pelegrinët myslimanë kanë filluar të mbërrijnë në Mekë për një përvojë shumë më të kufizuar se në vitet e mëparshme. Zakonisht haxhillëku mbledh 2.5 milionë besimtarë për pesë ditë lutjesh e ritualesh intensive në një nga grumbullimet më të mëdha në botë. Këtë vit, Ministria saudite e Haxhillëkut parashikon pjesëmarrjen e 1 mijë - 10 mijë besimtarëve që janë aktualisht me banim në Arabinë Saudite.



# Botohet libri 'Imigrimi nga Ballkani Perëndimor' i bashkautores Vjollca Hajdari

*Vjollca Hajdari: “Ky libër është vetëm fillimi. Më ka dhënë impuls që të fokusohem në peripecitë e shqiptarëve me qëndrim ilegal në Gjermani dhe të hulumtoj rreth të drejtave ligjore të shqiptarëve në integrim dhe punësim”*




**Prishtinë, 28 korrik** - Pikërisht në kohën kur Gjermania debaton lidhur me ardhjen e vazhdueshme të emigrantëve nga gjithë Ballkani Perëndimor, doli në shtyp libri në gjermanisht “Imigrimi nga Ballkani Perëndimor”.

Shqipëria, Kosova, Maqedonia Veriore, Mali i Zi dhe Serbia janë vendet të cilat trajtohen në libër meqë numri i njerëzve të cilët marrin rrugën për në Gjermani është duke u rritur nga dita në ditë. “Arsyet janë çështja politiko-ekonomike në vend, ndaj një numër i madh nga Kosova dhe Shqipëria kanë kërkuar azil vitet e fundit. “Problemi më i madh që paraqitet në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut është ikja e trurit dhe e fuqisë punëtore, e cila kërkon mundësi punësimi në Gjermani”, ka pohuar Vjollca Hajdari, bashkautore e librit.

Ajo ka përmendur arsyet që i shtyjnë shqiptarët ta braktisin vendin e tyre dhe ka bërë përpjekje që t'i vë në pah pengesat me të cilat ata ballafaqohen kur mbërrijnë në shtetin gjerman.

E ashtuquajtura “Rregullore e Ballkanit Perëndimor” është temë qendrore në këtë libër dhe sjell një dinamikë të re në gjithë tematikën rreth qëndrimit në Gjermani.

Përpos historive të suksesit të shumë mjekëve dhe akademikëve në fusha të ndryshme, për të cilat është shumë e lumtur, Vjollca Hajdari thotë se e brengos edhe ajo pjesa e “padukshme” e shqiptarëve, një numër i konsiderueshëm i tyre me qëndrim ilegal në Gjermani. “Ata s'kanë si të mbrohen nga parregullsitë. Ka shumë punëdhënës që e shfrytëzojnë situatën e tyre dhe nuk i paguajnë. Alarmante është gjendja e tyre shëndetësore dhe psikike, e ku nuk mund të trajtohen në mjekësi. Për kushtet në të cilat jetojnë, mos të flasim fare”, është shprehur ajo.

Sipas politologes shqiptare, ky libër është vetëm fillimi. “Më ka dhënë impuls që të fokusohem në peripecitë e shqiptarëve me qëndrim ilegal në Gjermani dhe të hulumtoj rreth të drejtave ligjore të shqiptarëve në integrim dhe punësim”, ka thënë Vjollca Hajdari.

Por jo vetëm ky grup i njerëzve has në vështirësi të tilla.

Libri pasqyron edhe situatën e shumë infermierëve dhe kuadrove të tjera punuese me të cilat përballen me një situatë fare të panjohur për ta. Problemi i banimit, qiratë e larta dhe kushtet jo të volitshme për banim janë vetëm ca nga problemet që i përmendin ata.

Libri “Imigrimi nga Ballkani Perëndimor” është një përmbledhje e historisë së migrantëve nga Ballkani, që nga koha e “Gastarbajterëve” dhe deri më tani. Autorët: Max Behrendt, Kareem Elcheikh, Marcus Engler, Vjollca Hajdari dhe Boris Zujko kanë analizuar intervistat e shumë migrantëve dhe ekspertëve ligjorë, duke u fokusuar më kornizat aktuale ligjore, politikat e integrimit dhe perspektivat në të ardhmen.

Ky libër, i cili është mbështetur nga Senati Gjerman për Integrim, Punë dhe Çështje Sociale, ishte shkruar para krizës së pandemisë dhe ka përfunduar gjatë Covid-19. Mu për këtë situata aktuale me koronavirusin është edhe një krizë dhe sfidë e re, me të cilën përballen migrantët në Gjermani. “Nuk ishte e lehtë, por ja që ne arritëm ta realizojmë këtë projekt”, thotë Vjollca Hajdari, e cila i është falënderuar Institutit për Arsim, Kërkim dhe Hulumtim “Minor” për besimin në punën e saj. Ajo, gjithashtu, ka shprehur mirënjohje për ekspertin për Migracion dhe Azil, dr. Marcus Engler, i cili ishte edhe udhëheqës i projektit.

Botuesi i librit “Imigrimi nga Ballkani Perëndimor” është Christian-Pfeffer-Hoffmann.






Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Prishtina dhe Ballkani 'luftojnë' për Kupë dhe për Evropë

Sot në stadiumin "Fadil Vokrri" zhvillohet finalja e Digitalb Kupës së Kosovës në futboll. Prishtina dhe Ballkani janë dy skuadrat që e kërkojnë trofeun e dytë më të rëndësishëm në futbollin e Kosovës, kurse fituesi i këtij trofeu e siguron pjesëmarrjen në Ligën e Evropës



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 KORRIK - Prishtina dhe Ballkani sot (e mërkurë) "luftojnë" për trofeun e Kupës dhe për daljen në Ligën e Evropës. Të dyja këto skuadra deri pak xhiro para fundit të kampionatit ishin në garën për titull, por dështuan përballë Dritës dhe Gjilanit që morën vendin e parë dhe të dytë. Për të shpëtuar këtyre skuadrave u duhet të triumfojnë në finalen e Kupës që zhvillohet sot në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 17:45.

Trajneri i Ballkanit, Ismet Munishi, një ditë para kësaj finale është lutur që skuadrën e tij ta shpërblejë Zoti me atë që e ka merituar. "Finalja e parë për trofeun e parë. Inshallah Zoti na jep aq sa e kemi merituar. Ne jemi të gatshëm dhe jemi të fortë. Respekt gjithkujt, veresi askujt. Zoti e bekoftë futbollin! Zoti i bekoftë njerëzit e drejtë! FC Ballkani, forca 'xhebrailat'! Forca Suharekë!", ka shkruar Munishi në profilin e vet në "Facebook". "Normalisht që presioni është më i madh te Prishtina. Kjo është një përparësi për ne. Do të jemi shumë më të qetë, jo më të relaksuar. Normalisht, tash nuk mund t'i zgjedhim problemet e Prishtinës. Ajo duhet t'i zgjedhë problemet në gjirin e vet. Ne sigurisht se do të synojmë t'i arrijmë objektivat tona", ka shtuar Munishi.

Futbollistët e Prishtinës nuk kanë dashur të flasin para kësaj ndeshjeje për shkak se klubi nuk i lejon, por në faqen zyrtare kanë bërë një postim rreth finales. "Të mërkurën finalja e 10-të për trofeun e 7-të. Prishtina të mërkurën duhet ta fitojë Kupën e Kosovës, pasi që nëpërmjet kampionatit ishte shumë e dobët para kundërshtarëve shumë të fortë për të dalë në tri vendet e para. Andaj, në 'Fadil Vokrri', të mërkurën nga ora 17:45, Prishtina do të provojë edhe një herë të dëshmojë që mund t'ia dalë dhe nuk është vetëm skuadra e katërt me cilësi dhe ta sigurojë pjesëmarrjen e katërt rresht në Evropë. Me shumë lëndime e mungesa, djemtë bardhekaltër kanë besimin që mund ta fitojnë trofeun e çmuar të Kupës së Republikës", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.

## SHKURT

### Tortoshi, trajner i Flamurtarit

Jusuf Tortoshi është emëruar trajner i skuadrës së Flamurtarit nga Prishtina. Flamurtari sezonin 2020/2021 do të bëjë gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Trajneri i dëshmuar në futbollin vendor në krye të skuadrës kuqezi e zëvendëson Sunaj Keqin, nën drejtimin e të cilit skuadra e Flamurtarit nuk arriti ta sigurojë mbijetesën në Superligë. "Pas shumë bisedimeve të gjata me Tortoshin para dhe pas përfundimit të Superligës kemi arritur te nënshkrimi i kontratës, ku brenda saj nuk mungojnë bashkëpunimi, sinqeriteti, profesionalizmi dhe në fund suksesi. Do të ketë ndryshime në klub si te futbollistët, po ashtu dhe te stafi", ka thënë Armend Ademi, drejtor i klubit kuqezi.

### Dy klube turke e kërkojnë Topallin

Ylli i Ballkanit, Blendi Baftiu, ka spikatur në këtë sezon në elitën e futbollit të Kosovës duke realizuar 19 gola. Ai ka tërhequr interesimin e dy skuadrave të mëdha turke Beshiktashit dhe Fenerbahçes. Lajmi është bërë publik nga media turke "IHA", teksa drejtuesit e klubit nga Suhareka, kërkojnë t'i mbushin arkat me shitjen e xhevahirit të tyre, i cili së fundmi u vlerësua edhe nga UEFA, në listën e 50 talentëve më të mirë që duhen vëzhguar.

### Pefqeli ndahet me Llapin

Mërgim Pefqeli nuk do të jetë më pjesë e Llapit. Lajmin e ka konfirmuar vetë Pefqeli nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook". "Ju informoj që kontrata ime me KF Llapin ka përfunduar dhe tashmë jam lojtar i lirë. Falënderoj kryesinë, stafin dhe të gjithë bashkëlojtarët që kaluam një sezon së bashku. Gjithashtu, falënderimi tjetër shkon për tifozët e KF Llapit për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo ndeshje", ka shkruar Pefqeli.

### Memaj largohet nga Dukagjini

Blendi Memaj i ka dhënë fund aventurës me skuadrën e Dukagjinit dhe këtë e ka bërë me dije përmes një njoftimi në "Facebook". "Të nderuar media, shokë dhe dashamirë të futbollit, dua t'ju njoftoj se pas përfundimit të këtij gjysmëstinori me fanellën e KF Dukagjinit, kemi përfunduar bashkëpunimin dhe mbetem lojtar i lirë", ka thënë Memaj. "Falënderoj stafin e trajnerëve, bashkëlojtarët si dhe tifozët 'Hithat' për respektin dhe mikpritjen gjatë kësaj periudhe gjashtëmujorëshe. Mirupafshim në sfidat e radhës!", ka shtuar Memaj.

### Rashica: E kam borxh të luaj për Kosovën

Futbollisti i Kosovës, Milot Rashica, nuk është penduar aspak për kalimin nga kombëtarja shqiptare te vendi i tij. Në një intervistë për emisionin "Ora Verore", ai u shpreh se është vendimi më i mirë që ka marrë në karrierë dhe se e ka pasur një "detyrim" moral për t'iu bashkuar duke qenë se ai është rritur në Kosovë. "Vendimi për t'iu bashkuar Kosovës nuk ka qenë një vendim kundër Shqipërisë. Ka qenë një vendim për ta ndihmuar Kosovën pasi ka qenë në hapat e parë të saj të formimit dhe ka pasur një nevojë të madhe. Unë jam lindur dhe jam rritur në Kosovë dhe në njëfarë mënyre ia kam pasur borxh asaj për të luajtur për të. Nëse nuk do të kthehesha unë aty, kush do ta bënte. Është një prej vendimeve më të mira që unë kam marrë deri më tani në karrierën time dhe shpresoj të vazhdojë e tillë", ka thënë Rashica, i cili ka folur edhe për ëndrrën evropiane të Kosovës, teksa shpreson te kualifikimi në Kampionatin Evropian. "Kemi përpara vetes dy ndeshje tepër të rëndësishme. Në kombëtare ne kemi kualitet dhe jemi një grup shumë i mirë. Kalojmë shumë mirë me njëri-tjetrin si në fushë ashtu dhe jashtë saj. Gjithashtu, kemi tifozë që na mbështesin dhe, pse jo, duam ta bëjmë ëndrrën realitet", ka shtuar Rashica.

## Boksierët vazhdojnë përgatitjet në Brezovicë



PRISHTINË, 28 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në Boks për grupmoshat 17-18 vjeçar po i vazhdon përgatitjet në Brezovicë. Sipas Federatës së Boksit të Kosovës, përgatitjet po zhvillohen duke i respektuar këshillat e dala nga Ministria e Shëndetësisë. Shumica e sporteve kanë mbetur pa aktivitete pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për t'i ndalur aktivitetet sportive në ambiente të mbyllura, me qëllim të parandalimit të pandemisë Covid-19.
Boksierët i ka vizituar kryetari i Federatës së Boksit, Sylejman Voca, së bashku me stafin punues të FboxK, sekretarin e përgjithshëm Mehmet Bogujevci dhe sekretarin teknik Latif Demolli.
Përgatitjet e boksierëve po zhvillohen në lartësi mbidetare 1200-1700 metra në ambient të hapur, ku po u kushtohet rëndësi forcës, kondicionit dhe qëndrueshmërisë. Në këtë kamp po marrin pjesë 10 boksierë, të cilët po ushtrojnë nga tri herë në ditë.
Federata e Boksit po e shikon mundësinë e organizimit të turneut ndërkombëtar "Lah Nimani", i cili është shtyrë për shkak të pandemisë Covid-19, e i cili është pikërisht për moshat 17-18 vjeç.

# Rama: Uroj që kjo situatë mos t'i përsëritet më Drenicës



SKENDERAJ, 28 KORRIK (ER) - Skuadra e Drenicës e siguroi mbetjen në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Trajneri i skuadrës kuqezi nga Skenderaj, Fadil Rama, ndihet shumë i lumtur për suksesin e arritur me këtë klub, derisa uron që kjo situatë të mos i përsëritet më Drenicës. "Edhe me tej në Superligë. Synimet u arritën dhe të gjithë ndihemi të lumtur. Do të garojmë prapë në Superligë. Uroj të gjithë lojtarët për kontributin e dhënë, angazhimin maksimal, disiplinën dhe seriozitetin në punë, karakterin dhe vendosmërinë e tyre të pastër deri tek arritja e qëllimeve tona. Po ashtu, uroj stafin tim që së bashku punuam me vullnet të madh. Falënderoj mjekët tanë që gjithherë ishin afër nesh", ka thënë Rama. "Uroj edhe kryesinë e klubit, në krye me presidenten Mihane Kodra-Bekteshi, e cila na qëndroi pranë e që nuk u ndal asnjëherë, vetëm që ne të kemi mundësi të punojmë për realizimin e qëllimeve tona. Një falënderim shkon edhe për drejtorin sportiv, sekretarin e klubit dhe 'Shqiponjat e Zeza' për përkrahjen e madhe të tyre si çdoherë. Shpresoj të mos gjendemi në situata të tilla në të ardhmen, të organizohemi më mirë dhe më kohë", ka shtuar Rama.

# Rexhepi: Synoj të luaj për Përfaqësuesen A



PRISHTINË, 28 KORRIK - Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë disa basketbollistë/e të Kosovës që po luajnë me sukses derisa numri i tyre po rritet. Një ndër ta është edhe Donat Rexhepi. 18-vjeçari, i cili ka luajtur për grupmoshat e Kosovës, ka nënshkruar marrëveshje njëvjeçare me një ndër shkollat më me renome në ShBA "Miami Prep". Për ish-basketbollistin e Kerasan Prishtinës ky pritet të jetë vetëm fillimi, në një aventurë të suksesshme në ShBA. "Kalimin në ShBA më kanë mundësuar trajnerët Dritëro Sefaja, Kirk Meyerson edhe shkolla Salesian College Preparatory. Jam diplomuar në Salesian, kurse tani hapi tjetër është të luaj me një program tjetër në Floridë, Miami Prep. Shpresoj se do të kaloj në ndonjë kolegj D1 pas këtij sezoni", ka thënë Rexhepi për faqen zyrtare të FBK-së. Ai ka folur edhe për ndjenjën për ta luajtur për Kosovën. "Të luaj për Përfaqësuesen A është gjithmonë prioriteti më i madh sa i përket basketbollit. Gara që e pres me padurim është gjithmonë Kampionati Evropian, sepse mund ta prezantoj shtetin dhe të luaj së bashku me shokët ndaj përfaqësueseve kundërshtare", ka shtuar Rexhepi.

## Sulmuesi i Realit rezulton pozitiv me Covid-19

Real Madridi ka konfirmuar se Mariano Diaz ka rezultuar pozitiv për COVID-19 dhe se tashmë është izoluar në shtëpinë e vet. Klubi spanjoll me anë të faqes zyrtare njoftoi: "Pas testimit për COVID-19, ne u njoftuam se futbollisti ynë, Mariano Diaz, ka rezultuar pozitiv. Futbollisti është në gjendje të mirë shëndetësore dhe është izoluar në shtëpinë e vet". Më tej, mediat spanjolle kanë bërë me dije se ai nuk ka stërvitur të martën me bashkëlojtarët e tij. Gjithashtu, është konfirmuar se ai nuk ka pasur kontakt me futbollistët e tjerë nga java e kaluar.

## SHKURT

### Jones: Benn duhet ta pranojë duelin ndaj Markut

Florian Marku kërkon të ndeshet me Connor Benn dhe ka nisur thumbimet ndaj këtij të fundit. Benn nuk pranon të ndeshet me "Luanin shqiptar" dhe agjenti i Markut, Sam Jones, foli për "Sky Sport" për mundësinë e zhvillimit të kësaj ndeshjeje. Ai tregoi se sa mbështetje ka Marku dhe se do të ishte i duhuri për Connor Benn. "Florian Marku është rivali i duhur për Connor Benn. Çdo foto që poston ka miliona shqiptarë në komente që shkruajnë: Marku, Marku. Është e pashmangshme, Eddie Hearn duhet ta organizojë këtë duel. Ne jemi gati. Jemi të bindur që do të kemi mbi 20 mijë tifozë në O2 Arena dhe 20 mijë tifozë jashtë saj. Edhe në stil do të ishte një duel për të mos u humbur. Të dy godasin fort dhe nuk shmangen. Duhet që Benn ta pranojë sfidën", ka deklaruar Jones.

### Garcia, trajner i Valencias

Javi Garcia është zyrtarisht trajneri i ri i Valencias. Spanjolli nënshkroi marrëveshje dyvjeçare me "Los Che" të cilët e mbyllën La Ligan në vendin e 9-të, jashtë zonës që do t'u jepte mundësi të luanin në Europa League sezonin e ardhshëm. Pronari i Valencias, Peter Lim, i ndezi dritën jeshile presidentit Anil Murthy për emërimin e ish-trajnerit të Watfordit. Ai ka përvojë në futbollin spanjoll edhe me ekipe të tilla si Malaga, Osasuna e Almeria. Garcia i ka bindur drejtuesit e Valencias me vizionin e tij për klubin në një takim që u zhvillua javën e kaluar. Objektivi i këtij projekti të ri është që ta kthejë skuadrën në Ligën e Kampionëve.

### Pesë klube në garë për Willianin

Futbollisti i Chelseat, Willian, ka oferta nga pesë klube të ndryshme dhe këtë e ka zbuluar agjenti i brazilianit, Kia Jorabçian. Kontrata e Willianit me ekipin anglez skadon në fund të gushtit dhe duket se do ta lërë skuadrën pas shtatë vjetësh në klub. Braziliani ka dy oferta nga Premierë Liga, dy oferta nga Evropa dhe një nga kampionati amerikan i futbollit MLS. Willian do të vendosë për të ardhmen e tij pas finales se Kupës së Anglisë.

### Buffon: Jam krenar për veten, tashmë e kam arritur objektivin

Juventusi siguroi pak ditë më parë titullin e nëntë radhazi në Serinë A. Në kampin bardhezi janë të gjithë të lumtur, ku dhe Gianluigi Buffon nuk ngurron ta shprehë gëzimin për këtë arritje. Italiani u kthye sërish këtë sezon te "Zonja e Vjetër", pas një aventure te francezët e PSG-së. "Jam shumë i lumtur. Unë kisha një synim për të fituar 10 Scudetto, pasi dy na i vodhën. Tashmë që e arrita këtë numër jam shumë i kënaqur me veten. Ia dola mbanë, madje vendosa dhe rekordin për më shumë paraqitje", ka deklaruar gardiani për "Il Corriere dello Sport". "Ne e fituam titullin, por ishte një vit shumë i vështirë për ne. Unë jam përshtatur gjithmonë, pasi jam dhe altruist nga natyra. E kam vënë veten në test. Jam krenar për veten sepse e kam kaluar atë. Unë gjithmonë nuk e kam pëlqyer arrogancën dhe të them se jam më i miri, por bashkëpunimi me Szczesnyn më ka ndihmuar të kuptoj se ku jam", ka shtuar 42-vjeçari.

# WE Women in Energy Internship Program

## — SALES ENGINEER

**About the Company**
JAHA Solar was established on 2015 and has two core business areas: production and sale of Solar PV panels, as well as, sale and installation of turn-key PV Systems. JAHA Solar Factory provides products – photovoltaic solar panels with high performance and quality, meeting the most advanced standards, including Certification with TUV based on standards IEC 61215 and IEC 61730, that are the worldwide known certification for quality and safety.

**Job Tasks**
Together with colleagues:
- Prepare proposals, quotes, contracts, or presentations for potential solar customers.
- Develop content for sales presentations or other materials.
- Develop proposals for current or prospective customers.
- Prepare sales or other contracts.
- Explain technical product or service information to customers.
- Gather customer or product information to determine customer needs.
- Identify potential local and international customers.
- Take quote request or orders from dealers or customers
- Take product orders from customers.
- Develop marketing or strategic plans for sales territories.
- Develop marketing plans or strategies.

**Job Description**
- Communicating with people outside the organization, representing the organization to customers, the public, government, and other external sources. This information can be exchanged in person, in writing, or by telephone or e-mail.
- Developing specific goals and plans to prioritize, organize, and accomplish your work.
- Keeping up-to-date technically and applying new knowledge to your job.
- Developing, designing, or creating new applications, ideas, relationships, systems, or products, including artistic contributions.
- Identifying information by categorizing, estimating, recognizing differences or similarities, and detecting changes in circumstances or events.
- Other activities upon superiors request.

**Qualifications**
- Excellent communication skills - English is a must
- Proficiency in Microsoft tOffice package
- Ability to work independently in small teams
- Work self-motivated
- Basic knowledge on engineering (in solar preferably).
  **Note:** Upon successful internship our company will present a full-time permanent job offer for selected candidate.

**Apply**
millenniumkosovo.org/womeninenergy

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO
MILLENNIUM CHALLENGE CORPORATION UNITED STATES OF AMERICA

# WE Women in Energy Internship Program

## — INXHINIERE E SHITJEVE

**Rreth Kompanisë**
JAHA Solar është themeluar në vitin 2015 dhe ka dy fusha kryesore të biznesit: prodhimin dhe shitjen e paneleve PV solare, si dhe, shitjen dhe instalimin e Sistemeve PV të tipit 'me çelësa në dorë' (turn-key). Fabrika JAHA Solar ofron produkte - panele solare fotovoltaike me performancë dhe cilësi të lartë, duke përmbushur standardet më të avancuara, përfshirë Certifikimin me TUV bazuar në standardet IEC 61215 dhe IEC 61730, që janë çertifikim i njohur në të gjithë botën për cilësi dhe siguri.

**Detyrat e vendit të punës:**
Së bashku me kolegët:
- Përgatit propozime, kuota, kontrata ose prezantime për klientët potencialë të solareve.
- Zhvillon përmbajtje për prezantime në shitje ose materiale të tjera.
- Zhvillon propozime për klientët aktualë ose të ardhshëm.
- Përgatit kontrata të shitjes ose të tjera.
- Shpjegon informacionin teknik të produktit ose shërbimeve për klientët.
- Mbledh informacione për klientin ose produktin për të përcaktuar nevojat e klientit.
- Identifikon klientët e mundshëm vendorë dhe ndërkombëtarë.
- Merr kërkesën e kuotës ose porositë nga tregtarët ose klientët
- Merr porositë e produkteve nga klientët.
- Zhvillon plane marketingu ose strategjike për territoret e shitjeve.
- Zhvillon plane ose strategji të marketingut.

**Aktivitetet e punës:**
- Komunikimi me njerëzit jashtë organizatës, përfaqësimi i organizatës tek klientët, publiku, qeveria dhe burime të tjera të jashtme. Këto informacione mund të shkëmbehen personalisht, me shkrim, ose me telefon ose me postë elektronike.
- Zhvillimi i qëllimeve dhe planeve specifike për prioritizimin, organizimin dhe realizimin e punës suaj.
- Informimi i vazhdueshëm në aspektin teknik dhe aplikimi i njohurive të reja në punën tuaj.
- Zhvillimi, hartimi, ose krijimi i aplikacioneve, ideve, marrëdhënieve, sistemeve, ose produkteve të reja, përfshirë kontributet artistike.
- Identifikimi i informacionit duke kategorizuar, vlerësuar, duke njohur dallimet ose ngjashmëritë, dhe duke zbuluar ndryshime në rrethana ose ngjarje.
- Aktivitete të tjera sipas kërkesës së stafit më të lartë.

**Requirements**
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi - gjuha angleze është e domosdoshme
- Zotësi në pakon e Microsoft Office
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur në ekipe të vogla
- Të punojë i vetë-motivuar
- Njohuri themelore për inxhinierinë (preferohet në solare).
  **Shënim:** Pas punës praktike të suksesshme, kompania jonë do të paraqesë një ofertë pune të përhershme me orar të plotë për kandidatin e zgjedhur.

**Apply**
millenniumkosovo.org/womeninenergy

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO
MILLENNIUM CHALLENGE CORPORATION UNITED STATES OF AMERICA

# WE Women in Energy Internship Program

## — PRODAJNI INŽENJERKA

**O Kompaniji**
JAHA Solar osnovan je 2015. godine i ima dva osnovna područja poslovanja: proizvodnju i prodaju solarnih PV panela, kao i prodaju i ugradnju PVC-a po sistemu „ključ u ruke".
JAHA Solar Factory nudi proizvode - fotonaponske solarne panele visokih performansi i kvaliteta, koji ispunjavaju najnaprednije standarde, uključujući i sertifikaciju TUV-om na osnovu standarda IEC 61215 i IEC 61730, koji je svetski poznati sertifikat za kvalitet i sigurnost.

**Opis Poslova**
- Priprema predloga, kvota, ugovora ili prezentacije za potencijalne solarne kupce.
- Razvoj sadržaja za prodajne prezentacije ili drugih materijala.
- Razvoj predloga za trenutne ili potencijalne kupce.
- Priprema prodajnih ili drugih ugovora.
- Objašnjavanje kupcima podataka o tehničkom proizvodu ili usluzi.
- Prikupljanje podataka o kupcu ili proizvodu radi određivanja potreba korisnika.
- Identifikacija potencijalnih domaćih i stranih kupaca.
- Preuzimanje zahteva za kvotama ili narudžbi od trgovaca ili kupaca
- Preuzimanje narudžbi od kupaca.
- Razvoj marketinških ili strateških planova za prodajne teritorije.
- Razvoj marketinških planova ili strategije.

**Radne aktivnosti**
Komunikacija sa ljudima izvan organizacije, predstavljanje organizacije kupcima, javnosti, vladi i drugim eksternim izvorima. Te se informacije mogu razmeniti lično, pismeno ili telefonom ili e-mail-om.
- Razvoj određenih ciljeva i planova za određivanje prioriteta, organizovanje i izvršavanje rada.
- Ažuriranje tehničkog znanja i primena novih znanja na poslu.
- Razvoj, dizajniranje ili kreiranje novih aplikacija, ideja, odnosa, sistema ili proizvoda, uključujući umetničke doprinose.
- Prepoznavanje informacija kategorizacijom, procenom, prepoznavanjem razlika ili sličnosti i otkrivanjem promena u okolnostima ili događajima.
- Ostale aktivnosti prema zahtevu nadređenog.

**Kvalifikacije**
- Odlične komunikacione veštine – Poznavanje engleskog jezika je obavezno
- Poznavanje rada sa paketom Microsoft Office
- Sposobnost samostalnog rada u malim timovima
- Radna samo-motivacija
- Osnovno znanje o inženjeringu (poželjno o solarnom).

**Napomena:** Nakon uspešnog staživanja naša kompanija će predstaviti stalnu ponudu za posao izabranom kandidatu.

**Apliciraj**
millenniumkosovo.org/womeninenergy

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO
MILLENNIUM CHALLENGE CORPORATION UNITED STATES OF AMERICA

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Unica Sallon", SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 810146424, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Unica Sallon" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810146424, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Unica Sallon" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810146424 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

## SHPALLJE E REKRUTIMIT

**Komuna e Kaçanikut,** në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik, më 29.07.2020 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

**I. Ndihmës punëtor**

**Drejtoria:** për arsim dhe kulturë
**Njësia/sektori**: i kulturës
**Koeficienti aktual**- 5
**Numri i referencës së vendit të punës:** 04-111/01-17216

**Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Ofron mbështetje të përgjithshme teknike për mbikëqyrësin e tij;
2. Menaxhon kalendarin e takimeve dhe ngjarjeve tjera për mbikëqyrësin si dhe ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi administrativ dhe teknik;
3. Ndihmon në hartimin e listës së nevojshme për mirëmbajtjen e higjienës së objektit;
4. Ruan dhe mirëmban sistemin elektronik dhe kopjet fizike të dokumenteve dhe dosjeve të zyrës së mbikëqyrësit
5. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i tij.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedura e konkurimit:** është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit ekzistues.

**Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe atribute tjera që kërkohen:**

- Diplomë e shkollës së mesme
- Shkathtësi në komunikim ;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:** Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik .
**Kohëzgjatja e emërimit :** pa afat të caktuar
**Data e mbylljes së konkursit;** Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 29.07.2020 deri më 12.08.2020 .
**Paraqitja e kërkesave:** Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar **-Zyra e pranimit,** kati përdhesë dhe në web-faqen komunale .
**Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente:** Diplomën e shkollës së kryer apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, dëshminë se nuk është në hetime.
***"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë". "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qëndrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"***
Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.
Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuara, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

---

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

## OGLAS REGRUTOVANJA

**Opština Kačanik,** na osnovu člana 8 Zakona Rada Br.. 03/L-212 ,kao i Administrativnog Uputstva Br. 07/2017 O Regulisanje procedura konkursana javnom sektoru dana 29.07.2020 objavljuje konkurs o popunjavanju slobodnog radnog mesta :

**I.** Radnik asistent

**Uprava:** Uprava Obrazovanja i kulture
**Odelenje**/sektor kulture
**Aktuelni Koeficient**- 5
**Broj reference radnog mesta:** 04-111/01-17216

**Zadaci i Odgovornosti**

1. Pruža opštu tehničku podršku svog pretpostavljenog;
2. Menadžira kalendar sastanaka i ostalih događaja koji se tiču nadzornika, kao i pomaže na rešavanju određenog administrativnog i tehničkog problema;
3. Pomaže u sastavljanju spiska potrebnog za održavanje higijene objekta;
4. Čuva i održava elektronski sistem i fizičke kopije dokumenata i dosijea kancelarije nadzornika
5. Izvršava druge zadatke u skladu sa zakonima i uredbama koje se mogu zahtevati na razuman način i povremeno od strane nadzornika;

**Uslovi učestovanja u regrutovanju**

- U civilnoj službi imaju pravo zapošljavanja ,državljani Republike Kosovapunoletnog uzrasta, koji imaju puno sprenosti za delovanje ,poseduju civilna i politicka prava ,imaju potrebnu obrazovnu spremu i profesionalnu sposobnost za vršenje izvršnih ,upravnih obaveza ili sprovodjenje administrativnih funksija i koji imaju fizicku sposobnost koja se zahteva za doticnu poziciju..

**Procedure konkurisanja:** otvorena za sve vanjske kandidate, kao i postojece civilne službenike...

**Školska sprema, Sposobnosti,iskustvo i ostali drugi atributi koji se traže:**

- Diploma srednje škole,
- Vrline komuniciranja ;
- Sposobnost za ispunjavanje zadataka I poslova pod presijom

**Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje:** Izabranje vrši se oslanjajuci se na Zakon o Radu Br03/L-212 i Administrativnog Uputstva Br. 07/2017 Regulisanje procedura konkursana javnom sektoru
**Vremetrajanje imenovanja :** neograniceno
**Data zakljucenja konkursa;** Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objevljivanja u sredstvima javnog informisanja 29.07.2020 do 12.08.2020 .
**Podnošenje zahteva:** Formulari apliciranja uzimaju se i dostave u skriptarnici-Prijemno odelenje prizemlje i na službenoj Web stranici opštine .
**Aplikaciji treba priložiti ova dokumenta:** Diplomu završene škole ili Overavano kopije Diplome,kopije lične karte,izvod-ekstrakt rodjenja,,dokaz da nije pod istragom..
***"Civilna služba Kosova nudi ravnopravne mogučnosti zapošljavanja za sve gradjane Republike Kosova,i ocekuje aplikacije od svih lica muškog i ženskog roda svih zajednica Kosova"***
***"Zajednice manjine i njihovi pripadnici imaju pravo ravnopravnog i proporcijanog predstavljanja u organima civilne službe javne administracije lokalne i centralne ,kako se specificiraju u clanu 11 ,paragraf 3 Zakona Br..03/L-149 Civilne službe Republike Kosova"***
Zahtevi dospeli posle istekanja roka nece si primiti.Nekompletirani dokazi mogu se odbijati..
Zbog velikog broja primljenih zahteva ,samo kandidati izabrani u tesnoj listi ,ce se kontaktirati.Za svaku informaciju kandidati mogu da kontaktiraju kancelariju personala..

Predsednik Opštine
Besim Ilazi

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

---

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr-4- 111 – 31901
Datë: 28-07-2020

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan shpall:

## KONKURS
### Për plotësimin e vendeve të punës

**I. SHFMU "Ismail Luma" Lipjan**
Një (1) Edukator/e (Zëvendësim)
Dy (2) Mësues/e klase (Zëvendësim)
Një (1) Mësimdhënës/e për Edukatë Muzikore (Zëvendësim)
Një(1) Punëtor/e teknik në PNF Jeta e Re (Vend i lirë)

**II. SHFMU "17 Shkurti" Gllogovc**
Një (1) Mësues/e klase (Vend i lirë)

**III. SHFMU "Katër Dëshmorët" në Krojmir**
Një (1) Mësues/e klase (Zëvendësim)

**IV. SHFMU "Zenel Hajdini" në Gadime e E.**
Një (1) Mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane (Zëvendësim)
Një (1) Mësues/e klase PNF në Vrellë (Vend i lirë)

**V. SHFMU "Ibrahim Banushi" në Shalë PNF në Kleçkë**
Dy (2) Mësues/e klase (Vende të lira)

**VI. SHFMU "7 Marsi" Poturoc**
Një (1) Mësimdhënës/e për Gjeografi (10 orë vend i lirë)

**VII. SHFMU "Emin Duraku" në Banullë**
Një (1) Edukator/e PNF në Bujari (Zëvendësim)

**VIII. SHFMU "Hasan Prishtina" Llugaxhi**
Një (1) Mësimdhënës/e për Biologji (Zëvendësim)

**IX. SHFMU "Hasan Zuko Kamberi" Sllovi**
Një (1) Mësimdhënës/e për Matematikë (Zëvendësim)

**X. SHFMU "Ibrahim Krasniqi" Smallushë**
Një (1) Mësues/e klase (Zëvendësim)

**XI. SHFMU "Fehmi Agani" Medvec**
Një (1) Mësues/e klase (Vend i lirë)

**XII. SHFMU "Rexhep Akllapi" Akllap**
Një (1) Mësues/e klase (Vend i lirë)

**XIII. SHFMU "Vezir Kolshi" Baicë**
Dy (2) Mësues/e klase (Zëvendësim)

**XIV. SHML Gjimnazi "Ulpiana" në Lipjan**
Një (1) Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe (Zëvendësim)
Një (1) Mësimdhënës/e për Psikologji (14 orë zëvendësim)

**XV. Për plotësimin e normave në disa SHFMU**
Dy (2) Mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane (Vende të lira)

**Kushtet e kërkuara:**
Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Aplikacioni i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë sporteli nr. 3);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomë (Çertifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

**Kriteret e kualifikimit:**
Përgatitje adekuate profesionale, në bazë të normativit **10/2018 (MASHT),**

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Informi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhet në Web faqen e Komunës së Lipjanit https: https://kk.rks-gov.net/lipjan/ dhe në tabelën e shpalljeve.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimit real i vendit të punës (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit.

Dokumentet e pranuara nuk kthehen.

Drejtoresha e DKA-së
Elmaze Behluli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT
IV
LIPJAN
OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVA










### NJOFTIM

Telekomi i Kosovës Sh.A njofton se Bordi i Përkohshëm i Drejtoréve në kuadër të kompetencave të veta, me datë 28.07.2020, ka marrë vendim për anulimin e konkursit për pozitat: Kryeshef Ekzekutiv dhe Zyrtar Kryesor i Financave dhe Thesarit, i publikuar në shtypin ditor me datë: 15.07.2020.
Ky vendim është marrë pasi Bordi është njoftuar nga Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në kuadër të MEA së Qeveria e Republikës së Kosovës ka lidhur Memorandum Bashkëpunimi me Ambasadën Britanike për asistencë që nga fillimi i procesit, lidhur me përzgjedhjen e pozitave të larta.

I falënderojmë të gjithë aplikantët për shprehjen e interesimit për të qenë pjesë e TK Sh.A, dhe i lusim që të shohin web faqen e kompanisë për konkurset publike, në të ardhmen.

### OBAVEŠTENJE

Telekom Kosova d.d. obaveštava da je Privremeni Bord Direktora, u okviru svojih ovlašćenja doneo odluku o poništenju konkursa za radna mjesta: Izvršni direktor i Glavni službenik za finansije i trezor, objavljen u dnevnoj štampi dana 15.07.2020.
Ova odluka je doneta posle informisanja Borda od strane jedinice za Nadzor Javnih Preduzeća, u okviru MEŽS o potpisivanju Memoranduma o Saradnji, sa ambasadom Ujedinjenog Kraljevstva, o njihovom ućestvovanju u proces regrutovanja viših rukovodećih pozicija.

Zahvaljujemo svim kandidatima na iskazanom interesovanju da budu deo TK d.d. i upućujemo ih da i ubuduće posjete web stranicu kompanije, da bi mogli da prate naše buduće javne konkurse.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Mirsad Elmazi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

▶ Luljeta Thaqi shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

▶ Arbreshe Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl l - Vlll shf " Leke Dukagjini " Prizren.

▶ Shala Construction" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik 810874025, nrb. 71352897 nr. fis. 601733703

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L